



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 19.05.2020, ora 11:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 8 dhe 12 maj 2020.
2. Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Besa Shahini, në lidhje me vijimësinë e procesit mësimor në arsimin parauniversitar dhe në atë universitar në kushtet e pandemisë dhe masat e marra nga MASR-ja dhe institucionet ligjzbatuese në varësi të saj për hapjen e shkollave për maturantët, si dhe të auditorëve të studentëve që diplomohen në vitin akademik 2019 - 2020 e të tjera.

#### **Marrin pjesë:**

Fatjona Dhimitri, Mirela Kumbaro, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Amra Barova, Selami Jenishehri, Kostaq Papa dhe Erion Piciri.

#### **Mungojnë:**

Almira Xhembulla, Klajdi Qama dhe Enada Kapllani.

#### **Të ftuar:**

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,  
Oltion Rrumbullaku – Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,  
Zamira Gjini – drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## HAPET MBLEDHJA

**Fatjona Dhimitri** – Përshëndetje!

Përpara se të fillojmë mbledhjen e radhës së komisionit, verifikojmë prezencën.

Zonja Kumbaro? Prezente.

Zoti Ramazan Gjuzi? Po.

Zoti Fidel Ylli? Po.

Zoti Musa Ulqini? Po.

Zonja Vilma Bello? Po.

Zoti Ismet Beqiraj?

**Ismet Beqiraj** – Mirëmëngjesi, kryetare!

**Fatjona Dhimitri** – Mirëmëngjesi!

Zoti Fadil Nasufi?

**Fadil Nasufi** – Present.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Adelina Rista?

**Adelina Rista** – Prezente.

Zoti Bujar Çela?

**Bujar Çela** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Xhembulla? Nuk është prezent.

Zonja Nikolla?

**Lindita Nikolla** – Present.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Enada Kapllani? Nuk është prezent. Zoti Klajdi Qama?

Nuk është prezent. Zoti Kostaq Papa?

**Kostaq Papa** – Present.

**Fatjona Dhimitri** – Zoti Selami Jenishehri?

**Selami Jenishehri** – Present.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Amra Barova? Po. Zoti Erion Piciri? Po.

Përpara se të vijojmë me rendin e ditës, nuk mund të anashkalojmë si komision atë që ka ndodhur 2 ditë më parë: shembja dhe aktet barbare që iu bënë tempullit të kulturës në Shqipëri: Teatrit Kombëtar. U shemb streha e artistëve shqiptarë, e atyre artistëve që ngritën në pedestal kulturën shqiptare. Kryeministri juaj dhe kryetari bashkiak monist i tmerruan shqiptarët përmes këtij akti barbar. Nën errësirën e natës, artistët shqiptarë u zgjuan të tmerruar nga fadromat që shembën teatrin e artistëve. E dënojmë këtë vepër, këtë akt të Kryeministrit tuaj dhe të kryetarit tuaj bashkiak monist. Si është e mundur që arriti ta kthejë Shqipërinë në

diktaturë përmes këtij akti? Si është mundur të shembet shtëpia e artistëve?! Si është e mundur të dhunohen gazetarët, reporterët, misionarët e lajmit të parë? Si është e mundur të dhunohen artistët në Shqipëri?

**Fidel Ylli** – Këto thuaji te PD-ja.

**Fatjona Dhimitri** – Ja pra, këto gjëra po ndodhin Po instalohet diktatura moderne.

**Mirela Kumbaro** - Zonja kryetare, a mund ta marr pak fjalën?

**Fatjona Dhimitri** – Të gjithë sot duhet të heshtin para këtyre akteve barbare të qeverisjes suaj.

**Mirela Kumbaro** – Zonja Kryetare, a mund ta marr fjalën?

**Fatjona Dhimitri** – Jo, Mirela, këtu është shkelur çdo procedurë jo më një procedurë komisioni. Nuk është hera e parë që Kryeministri ua pason topin grabitqarëve të tij, siç është Erion Veliaj, kryebashkiaku i betonit. Të arrish të shkatërrosh tempullin e artistëve, është krim.

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, a mund ta marr pak fjalën?

**Fatjona Dhimitri** – Jo, jo Mirela, absolutisht. Edhe pse nuk ishte parashikuar në rendin e ditës ky lloj haberi, ky lloj makthi që zgjoi të gjithë shqiptarët, nuk po devijoj nga rendi i ditës, në fakt, ky është sot rendi i ditës: teatri, shkatërrimi që ju i bëtë teatrit. Shkatërrimi që PS-ja, Kryeministri juaj, kryetari i bashkisë së betonit i bënë teatrit.

**Fidel Ylli** – A mund të vazhdojmë tani me rendin e ditës?

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, të lutem!

**Fatjona Dhimitri** – Mirela, është shkelur çdo procedurë dhe kjo procedurë është shkelur në mesin e natës, në errësirë, aty ku artistët po ruanin foltoren e tyre, strehëzën e tyre, fadromat, policia arritën t'i dhunojnë. Të shembet puna para syve, të shembet historia para syve, të shkatërrohen vlerat e identitetit kombëtar, të shembet historia e një kombi! Ja pra, ky është Kryeministri juaj!

**Fidel Ylli** – Është edhe yti.

**Mirela Kumbaro** – Lexoni çfarë keni aty përpara, mbarojeni dhe po ju presim të fillojmë mbledhjen.

**Fatjona Dhimitri** – Mirela, unë nuk marr urdhra nga askush. Nuk jam mëkëmbëse e askujt.

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri...

**Fatjona Dhimitri** – Në fakt, të gjithë ju duhet të heshtni përballë këtij akti barbar; të përuleni përpara turpit që u keni shkaktuar të gjithë artistëve aty. Të shembësh themelet e historisë së një vendi, do të thotë të shuash kombin komplet. Këtë po bëni ju.

Vijojmë me rendin e ditës: miratimi i procesverbaleve të datave 8 dhe 12 maj. Ka ndonjë kundërshtim, apo diskutim lidhur me to? Nuk ka.

Miratohen.

Në pikën tjetër të rendit të ditës është parashikuar një seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Besa Shahini, në lidhje me vijimësinë e procesit mësimor në arsimin parauniversitar dhe atë universitar në kushtet e pandemisë dhe masat e marra nga MASR-ja dhe institucionet ligjzbatuese në varësi të saj për hapjen e shkollave për maturantët, si dhe të auditorëve të studentëve që diplomohen në vitin akademik 2019 – 2020.

Të ftuar dhe prezentë janë: zonja Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zoti Oltion Rrumbullaku, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe zonja Zamira Gjini, drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Zonja Ministre, mund të vijoni me prezantimin e masave të mara. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet dhe diskutimet nga anëtarët e komisionit.

**Besa Shahini** – Faleminderit për ftesën!

Kemi punuar shumë këta 2 muaj e pak që ta vijojmë procesin mësimor, përkundrejt kushteve të jashtëzakonshme. Prandaj jam e lumtur që mund të prezantoj para jush disa nga arritjet, sfidat, por edhe planet për të ardhmen.

Në datën 9 mars, kur u identifikua rasti i parë i infektuar me koronavirus, qeveria shqiptare mori menjëherë masa për mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore dhe të institucioneve të tjera, në mënyrë që të parandalohet përhapja e koronavirusit, si e vetmja mënyrë për parandalimin e përhapjes së tij.

Në datën 9 mars janë mbyllur shkollat. Në datën 11 mars, diku 48 orë e pak më pas, kemi arritur të fillojmë me procesin e mësimin në kushtet e shtëpisë. Kemi dalë me transmetimin fillimisht të leksioneve në matematikë, pastaj edhe në lëndët e tjera në RTSH në 3 fasha orare dhe kemi vijuar me proceset e komunikimit *online* mes mësuesve dhe nxënësve. Nga data 11 mars, kur kemi filluar me procesin e mësimin në kushtet e shtëpisë, deri në datën 30 mars janë përfshirë rreth 97% e të gjithë nxënësve të arsimit parauniversitar në një komunikim *online* mes tyre dhe mësuesve.

Kemi pasur fleksibilitet në kërkesat ndaj mësuesve për llojin e platformave që duhet të përdorim në këtë proces. Duke marrë parasysh se shumica e familjeve shqiptare kanë një telefon celular *smart*, por nuk kanë *laptop* apo *tablet* kemi lejuar të përdoret edhe forma e rrjeti social *WhatsApp*, i cili është më shumë i përdorur në Shqipëri dhe përmes *WhatsApp*-it janë bërë edhe *video-selfie* nga mësuesit që kanë shpjeguar leksionet dhe kanë dërguar detyrat në shtëpi. Janë vlerësuar detyrat e shtëpisë dhe ka pasur një komunikim të vazhdueshëm mes

mësuesve dhe nxënësve. Janë përdorur edhe platforma të tjera. *Google Classroom* është platforma më e përdorur, ku diku te 60% e mësuesve dhe nxënësve janë përfshirë në përdorimin e kësaj platforme. Kjo është e rëndësishme, sepse aty ka një mundësi për krijimin e klasave virtuale dhe rikrijohet shumë më mirë klasa fizike e shkollës në një hapësirë virtuale. Mësuesit kanë qenë shumë të angazhuar dhe jemi befasuar nga angazhimi i tyre, duke treguar vullnet për të mësuar përdorimin e platformave, por edhe për të qenë vazhdimisht në kontakt me nxënësit. Kemi pasur raportim ditor të mësuesve të drejtorët e shkollave dhe drejtorët e shkollave të zyrat arsimore. Ne pastaj e kemi marrë këtë raportim.

Vetëm në 2 muajt e parë, diku në datën 10 maj, mësuesit kanë prodhuar rreth 1,2 milionë minuta *video-selfie*, video amatore, duke shpjeguar leksione që ishin shtesë mbi leksionet që kemi transmetuar në RTSH, të cilat kanë qenë video joamatore, por të incizuara me ekipe që janë të profesionalizuara në këtë fushë. Në RTSH, e kemi shkruar në raport, janë 20 mijë minuta të incizuara, por tani janë më shumë, janë 20 mijë e 500 minuta materiale dhe janë transmetuar vetëm gjysma e tyre, sepse gjithmonë kemi incizuar më shumë sesa kemi transmetuar. Disa nuk do t'i transmetojmë fare, sepse nuk kanë dalë shumë mirë për t'i transmetuar në Radiotelevizionin Shqiptar. Këto të dyja kanë qenë format kryesore të punës në kushtet e shtëpisë. Kemi shkruar udhëzues për mësues, për prindër dhe për nxënës, në mënyrë që të gjithë të jenë të qartë se si do të punohet në kushte shtëpie, si bëhet vlerësimi, cilat janë elementet kyçe që duhet të transmetohen gjatë mësimit në kushte shtëpie. Fillimisht sfidë ka qenë ngarkesa e tepërt, sepse mësuesit kishin një tendencë që të gjithë materialin mësuesor t'ua kalonin nxënësve, përkundër asaj që nuk e kishin hapësirën e klasës për ta bërë shpjegimin siç duhet. Prandaj është dashur të bëjmë një udhëzues, ku i orientojmë mësuesit që të merren vetëm me konceptet kryesore, me konceptet bazë, të bëjnë shpjegime sa më të qarta, t'i orientojnë nxënësit të shikojnë transmetimet në Radiotelevizionin Shqiptar, pastaj të bëjnë edhe komunikimin për detyrat e shtëpisë dhe pyetje-përgjigjet e tjera.

Një sfidë ka qenë edhe përshtatja e orareve me ato të prindërve, sidomos fëmijët e vegjël, nxënësit e klasave deri në të pestën kanë punuar përmes pajisjeve të prindërve të tyre, sepse nuk kanë pajisjet e tyre dixhitale dhe është dashur përsëri që t'i orientojmë mësuesit të gjejnë orare që janë të përshtatshme për shumicën e prindërve që janë të përfshirë në këtë proces.

Kemi zhvilluar dy sondazhe *online*: një ka qenë me 320 mijë respondentë dhe tjetra me 220 mijë respondentë. Kemi pyetur prindër, mësues dhe nxënës për vijimësinë e procesit *online*. Mësimi *online* dhe ndjekja e transmetimeve në RTSH në përgjithësi kanë qenë të kënaqshme me mënyrën se si është organizuar gjithë ky proces. Janë shprehur pozitivë për mësimin e

kompetencës dixhitale, si te nxënësit, ashtu dhe te mësuesit që e kanë përforcuar kompetencën e tyre dixhitale. Pjesa dërmuese e nxënësve ndihet se kanë mësuar edhe koncepte të reja. Pra, nuk ka qenë vetëm një proces ku kanë përforcuar konceptet që kanë mësuar deri në atë pikë, por kanë mësuar edhe koncepte të reja.

Me zbutjen e masave, ngaqë kemi edhe një numër të qëndrueshëm të rasteve të reja të infektimit me koronavirus, pra nuk po shtohet numri i të infektuarave, kemi filluar t'i lirojmë pak masat dhe kemi vendosur që është e sigurt të kthehen në shkollë një pjesë e nxënësve, në këtë rast janë maturantët, për të bërë përsëritjet e nevojshme dhe për t'u përgatitur për provimin e maturës. Nuk mund t'i kthejmë të gjithë nxënësit në shkollë, sepse shkollat tona kanë një numër të madh nxënësish dhe një pjesë e madhe punojnë me dy turne.

Fakti që tërmeti ka dëmtuar një pjesë të shkollave, gjithashtu, ka ndikuar që më shumë shkollat të shndërrohen në shkollë me dy turne, siç kanë qenë përpara, kështu që kemi vendosur të punojmë vetëm me maturantët në shkollë, të kthejmë vetëm ata në shkollë, t'i shpërndajmë në sa më shumë shkollë dhe në sa më shumë klasa, që të mos ketë më shumë se 10-12 maturantë në një hapësirë klasore.

Kemi marrë të gjitha masat e higjienizimit të shkollave, kemi blerë maskat dhe u kemi dhënë nxënësve maska shumëpërdorimshme, higjienizues të hapësirave dhe dezinfektantë për duart, pra i kemi marrë të gjitha masat që në kushtet e shkollës nxënësit të mund të bëjnë përsëritjet e nevojshme dhe të mos infektojnë njëri-tjetrin, nëse qëllon që dikush ka ndonjë problem me kontaktimin e koronavirusit, edhe pse ne jemi të bindur se kjo nuk do të ndodhë për shkak se nxënësit janë të detyruar të raportojnë në qoftë se kanë pasur raste në familjet e tyre dhe në qoftë se vërehet se kanë temperaturë të lartë, ata nuk lejohen të futen në shkollë.

Pra, janë ndërmarrë të gjitha masat që të mos na ndodhë diçka në shkollë gjatë kohës që nxënësit i kemi aty për përsëritjen e leksioneve për maturën.

Për nxënësit e tjerë, përmes udhëzuesve të detajuar, kemi orientuar mësuesit të bëjnë mbylljen e notave, me notat që janë marrë para datës 9 mars, pra në kushte shkollë dhe gjithë puna që është bërë në kushte shtëpie, në qoftë se përmirëson notën e nxënësit, merret gjithsesi parasysh, por nuk mund të penalizohen nxënësit për punën në kushte shtëpie, nëse ajo nuk është zhvilluar siç duhet për arsye të mungesës së pajisjeve.

Kemi pasur rreth 8400-9400 nxënës që nuk kanë marrë pjesë në komunikimet me mësuesit e tyre përmes platformës online, ngaqë nuk kanë pasur një pajisje në shtëpi. Me një donacion nga fondacioni Vodafon Albania kemi arritur t'i pajisim këta nxënës me një telefon celular smart, kështu ata kanë vijuar mësimin, po me një vonesë.

Jemi duke krijuar marrëdhënie edhe me donatorë të ndryshëm, që mund të na ndihmojë për të plotësuar numrin e nxënësve që janë pa tableta apo telefona smart, në mënyrë që vitin tjetër shkollor të mos kemi asnjë nxënës që nuk mund të marrë pjesë në mësimet online, në qoftë se duhet të kthehemi prapë në këtë formë të mësimet.

Sa i përket shërbimit psiko-social, kemi pasur edhe një organizim të të gjithë psikologëve, që t'u vijnë në ndihmë nxënësve, në qoftë se kanë pasur shqetësime që lidhen me procesin mësimor apo edhe shqetësime që lidhen thjesht me gjendjen e përgjithshme.

Në fund të marsit është themeluar shërbimi psikosocial dixhital dhe për katër javët e prillit kanë marrë shërbim rreth 2000 nxënës (këtu kemi shifrën 1321 nxënës, pasi kemi raportuar vetëm për tri javët e para, kurse sot kemi shifra më të përditësuar) dhe ky shërbim do të vijojë deri në mes të qershorit, kur mbyllet i gjithë procesi mësimor për nxënësit që nuk janë maturantë (mësimi do të përfundojë me 29 maj, pra 2 javë më herët se ç'është parashikuar), sepse duam që mësuesit të kthehen në ambientet e shkollës, ku kanë regjistrat dhe të mund të bëjnë përfundimin e notave dhe të të gjithë proceduarave administrative, ndërsa maturantët do të vijojnë të shkojnë në shkollë deri më 5 qershor.

Provimet do t'i bëjnë në qershor, siç janë parashikuar, mes datave 8-18 qershor, dhe të gjithë do të kenë mundësinë të marrin diplomat me kohë, ngaqë kishim edhe brengën për nxënësit që duan të aplikojnë për të studiuar jashtë vendit.

Kjo është sa i takon arsimit parauniversitar.

Arsimi i lartë organizohet në mënyrë autonome nga universitetet. Zëvendësministri i Arsimit ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me universitetet për të marrë edhe inpute nga ata në lidhje me organizimin e mësimet online. Shumica e lëndëve janë organizuar edhe online dhe shumica e studentëve kanë marrë pjesë në mësimet online, si te publiku, ashtu edhe te privati.

Kemi pasur më shumë problem me universitetet publike që të marrim informacion, sidomos 3-4 javët e para, por pastaj kjo është stabilizuar në prill dhe sot që flasim kemi të dhënat që na i sjellin rregullisht, një herë në javë.

Kemi zhvilluar edhe një sondazh me studentët, nuk është publikuar ende, por në momentin që do ta botojmë, do t'juaj dërgojmë. Studentët janë më pak të kënaqur me organizimin e mësimet online sesa arsimit parauniversitar dhe unë besoj se kjo është e kuptueshme, marrë parasysh se universiteteve iu desh më shumë kohë që të organizohen dhe të kalojnë online. Kjo edhe arsyeja që është marrë vendimi që të kërkohet nga universitetet të bëjnë një organizim më të mirë të punës që gjatë verës dhe kur të jetë e mundur, të hapen universitetet, të kthejmë pjesën e studentëve, të cilët ndihen se nuk kanë marrë mësim të

mjaftueshëm online, të kthehen nëpër auditore, duke respektuar distancimin social dhe të marrin njohuritë e nevojshme para provimeve të korrikut.

Kemi kërkuar nga universitetet të prioritarizojnë studentët që do të diplomohen, sepse nuk duhet të vonohet asnjë provim dhe në fund të gushtit të planifikojnë të punojnë me studentët e tjerë që duhet të bëjnë përsëritjet e nevojshme dhe pastaj provimet e vjeshtës. Kështu që të gjithë universitetet kanë rënë dakord të na i sjellin planet e tyre të punës deri më 15 maj, përveç Universiteti të Tiranës, që ka kërkuar një shyrje të kësaj date, deri më 21 maj.

Në vijimësi jemi duke punuar për tre elemente, në mënyrë që të sigurohemi se në vjeshtë mund të kalojmë përsëri online, nëse është e nevojshme, pra po përgatitemi për një valë të dytë të epidemisë; nuk do të thotë që do të ketë, por ne duhet të jemi gati.

Për arsimin e lartë duhet të bëjmë një normim të mësimit online. Kemi kërkuar nga universitetet të na sjellin propozimet e tyre (tashmë e kanë një eksperiencë, se si mësimi online është zgjatim i mësimit që bëhet në kushte universiteti) dhe se si mund ta organizojmë këtë mësimit të përzier, në universitet dhe online, si ky mund të zhvillohet në kushtet e Shqipërisë, në mënyrë që të jetë sa më i përshtatshëm për shumicën e studentëve.

Për arsimin parauniversitar jemi duke punuar në dy drejtime.

E para, duam që në RTSH (tashmë që ka hapur kanalin RTSH-shkolla, kanal që do të ketë vetëm transmetim materialesh shkollore), të bëjmë një planifikim për mbulimin e të gjitha lëndëve me mësuesit më të mirë që kemi, pra jo vetëm të lëndëve kryesore, si dhe me një pjesë të nxënësve, sidomos ata që mësojnë në klasa kolektive dhe nuk i kanë kushte shumë të mira në shkollë. Pra, ne mendojmë që këta nxënës mund të ndjekin mësimin nga televizioni, ndërsa në shkollë të kenë komunikimin me mësuesit për detyrat e shtëpisë dhe instruksione të tjera, dhe të shkojnë në shkollë vetëm për lëndët që duhet gjithsesi t'i bëjnë në shkollë, si edukata fizike apo lëndët që kërkojnë punë laboratorike apo diçka të ngjashme. Pra, ky është plani që mendojmë ta realizojmë gjatë verës, që shtatori të na gjejë me një repertor të plotë të mësimit që do të zhvillohet në kushte shtëpie, ose vetëm pjesërisht për nxënësit e klasave kolektive, ose plotësisht për të gjithë, nëse jemi të detyruar të mos hapim shkollat në vjeshtë.

Unë do ta ndërpres këtu. Besoj që materialet i keni lexuar, pasi ju kemi dërguar raportin e shkurtër të të gjithë punës që është zhvilluar online, dy sondazhet për arsimin parauniversitar, të gjitha udhëzimet që kemi hartuar dhe botuar gjatë kësaj kohe, prandaj unë besoj se, nëse keni arritur t'i shihni të gjitha këto materiale dhe nëse keni pyetje shtesë, mund të përgjigjem tani dhe unë të mos zgjatem më me pjesën e prezantimit.

Zamira Gjini dhe Oltion Rrumbullaku janë prezentë. Olti ka mbuluar pjesë e arsimit të lartë, ndërsa Zamira ka qenë pjesë përbërëse e ekipit të organizimit të punës për arsimin



parauniversitar dhe anëtare e komisionit të maturës. Ato mund të përgjigjen për pyetjet specifike në lidhje me këto fusha që kanë mbuluar.

Faleminderit!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, në vijim të deklaratave tuaja apo të videocall-eve tuaja, me ata nxënës, studentë dhe prindër që kam komunikuar, më janë dukur pak të çuditshme. Të njëjtat gjëra po i referoni edhe sot, vetëm me disa deformime në shifra. Keni deklaruar se 99% e shqiptarëve kanë televizor, 97% e tyre kanë telefon smart.

Zonja Ministre, nga këta 97% të shqiptarëve që kanë një telefon smart, a e dini ju, a kanë akses në internet? Nëse kanë akses në internet, mbulimi me internet, a është i njëjtë për të gjitha zonat? A siguron dot një mësimdhënie të kënaqshme?

Kurba e shifrës së nxënësve që nuk janë mbuluar nga shërbimin online për arsimin parauniversitar keni deklaruar se 10 mijë nxënës në arsimin parauniversitar nuk kanë ende një kontakt me mësuesit. Më pas, një deformim shifrash, thoni se vetëm 8 mijë nxënës në arsimin parauniversitar nuk kanë kontakt me mësuesit, pra i bie 2 mijë nxënës më pak. Nuk e keni studiuar mirë fizibilitetin, me sa duket.

Po për fëmijët e atyre familjeve që vuajtën pasojat e tërmetit të 26 nëntorit, çfarë është bërë? A i keni futur në këtë përlllogaritje edhe fëmijët e familjeve të romëve, të egjiptianëve, të cilët e kanë braktisur shkollën?

Lidhur me projektin e tabletave është shpenzuar 3,5 milionë euro për dixhitalizimin e mësimi. Çfarë është bërë më këto tableta, sepse ju deklaroni se tabletat janë në shkollë, nuk mund të dalin nga shkolla, se nuk ka karikues që t’i ngarkojë, veç atij që është në shkollë?

Zonja Ministre, ju përmendni suksesin e mësimdhënies online, por në fakt, sipas sonadazheve të kryera, mësimdhënia online, dhe ky nuk është sondazh i kryer nga unë, janë kontakte me pedagogë, me studentë, me nxënës, me prindër, që mësimdhënia *online* ka rezultuar e dështuar dhe në disa dimensione.

Shumë familje, të cilat janë me të ardhura minimale, e kanë pasur të pamundur t’u siguronin fëmijëve aparat celular me aplikacione bashkëkohore, për të ndjekur në të njëjtën kohë mësimdhënien tuaj *online*. Në ato zona rurale ku infrastruktura rrugore nuk ka përfituar asnjë investim në këta gjashtë vjet qeverisje, shihet e pamundur shtrirja e internetit.

Më rastisi që periudhën e karantinës ta kaloja në zonën time. Aty vura re se mësuesi, i cili jepte mësim në zona rurale, por jetonte në qytet, për të kontaktuar me nxënësit e tij në zonat rurale, detyrohej të merrte komshinjtë në telefon, për t’u thënë: më nxirrni nxënësin në telefon, t’i them që të lexojë ushtrimin nr. 2. Kjo sepse nxënësi dispononte vetëm një aparat celular të thjeshtë “Nokia”. Po në të tilla raste si i bëhet?

E përsëris edhe një herë. Nuk e di si i keni bërë llogaritë, kur keni nxjerrë kurbën e shifrave për fëmijët e familjeve që vuajtën pasojat e 26 nëntorit. Ato janë ende nën qiell të hapur. Nuk kanë marrë pagesën e qirasë, nuk janë rimbursuar akoma. Si e kanë ndjekur këta fëmijë mësimin *online*?

Gjithashtu, orët e mësimdhënies për ata nxënës që kanë pasur mundësi ta ndjekin mësimin *online*, kanë qenë të pamjaftueshme. Kjo gjë i ka detyruar prindërit, që së bashku me fëmijët, të thellohen në metodologjinë e mësimdhënies dhe t'ua rishpjegojnë edhe një herë mësimin atyre.

Vijojmë njëherë me përgjigjet e më pas kalojmë te pyetjet e tjera.

**Besa Shahini** – Faleminderit për pyetjet!

Atëherë, shifrat zyrtare në lidhje me numrin e pajisjeve dixhitale që kanë familjet shqiptare janë marrë nga INSTAT. Pra, janë bërë sondazhe të herëpashershme, ku ka rezultuar se 98% e familjeve shqiptare kanë televizor, 97% kanë telefon celular, që kryesisht është *smart*. Pra, këto janë shifrat që mund t'ju dërgoj me raport dhe mund t'i shihni vetë.

Nga eksperiencia jonë në këto gati tre muaj, si dhe nga raportimet e ardhura nga mësuesit të drejtorët e shkollave dhe nga drejtorët të zyrat arsimore dhe më pas te ne, janë vënë re se në fillim dhjetë mijë nxënës, më pas nëntë mijë dhe më pas tetë mijë e ca nuk kishin komunikim me mësuesit e tyre. Natyrisht, këto shifra kanë ndryshuar ndër javë, sepse komunikimi mes mësuesve dhe nxënësve është përmirësuar.

Pjesa e nxënësve që nuk kanë arritur të kenë asnjë komunikim me mësuesit e tyre, që janë nxënësit më të disavantazhuar, janë nga komuniteti rom, egjiptian, por janë edhe disa nxënës, të cilëve u janë dëmtuar shtëpitë për shkak të tërmetit.

Kjo është arsyeja pse ne kemi prioritetizuar këta nxënës, kur kemi marrë donacionin nga “Vodafone Albania” dhe rreth pesë mijë nga këta nxënës janë pajisur me telefona celularë.

Një donacion tjetër ka ardhur nga një kompani e Maqedonisë, “Ecolog”, e cila ka sjellë tableta, e kësaj edhe grupi tjetër i fëmijëve është pajisur me tableta. Ne kemi pasur prioritet fëmijët nga klasa e dymbëdhjetë e poshtë, sepse e kemi parë me vend që të rinjtë e klasave të dymbëdhjeta, pra maturantët, të kenë mundësi ta realizojnë komunikimin me mësuesit e tyre, me qëllim që të përgatiten për provimin e maturës.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, si është bërë shpërndarja e tabletave të fëmijët? Mos ndoshta sipas përpjesëtimit në militantë partiakë apo jo? Sepse më rezulton se shumë fëmijë, shumë nxënës, shumë studentë, shumë maturantë, që u përkasin familjeve në gjendje të vështirë ekonomike, nuk e disponojnë një aparat të tillë.

**Besa Shahini** – Sapo jua shpjegova, zonja Dhimitri. Nga grupi i fëmijëve që nuk kanë pasur një komunikim me mësuesit e tyre, për hir të mungesës së pajisjes dixhitale, që janë lista të grumbulluara e të ndërtuara ndër javë, duke marrë informacion ditor nga drejtoritë e shkollave, janë prioritizuar nxënësit më të mëdhenj, pra nga klasa e dymbëdhjetë e deri në klasën e gjashtë. Të gjithë këta nxënës që kemi pasur në listë janë pajisur me telefona. Grupi tjetër ka marrë tabletat, pra ata që kanë mbetur pa telefon.

Gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur një informacion ditor, që ka ardhur nga mësuesit te drejtorët e shkollave, e nga drejtorët e shkollave te zyrat arsimore dhe listat kanë qenë të gatshme, duke marrë parasysh ata njerëz që nuk kanë pasur komunikim me mësuesit e tyre. Po e theksoj edhe një herë: janë nxënës që vijnë nga kushtet e vështira ekonomike, vijnë nga komuniteti rom e egjiptian, si dhe nga disa familje të prekura nga tërmeti, të cilat nuk kanë pasur një pajisje dixhitale për të zhvilluar mësimin.

Më pyetët për tabletat që janë blerë me projektin e vitit 2014. Është pikërisht ashtu siç e thatë edhe ju: tabletat janë në shkollë. Pjesa kryesore janë në funksion, ndërsa një pjesë janë amortizuar, por është një përqindje e vogël. Ato tableta ishte e vështirë të nxirreshin nga shkolla, sepse nuk kanë karikues mobil, por e kanë karikuesin në laboratorin e sallës së kompjuterëve, në laboratorin dixhital. Kësisoj, është e vështirë të nxirren nga shkolla, sepse bëhen të papërdorshëm. Ato tableta mund t’i përdorin nxënësit jashtë shkollës, në kushtet kur shkolla është e hapur. Nxënësi mund të shkojë ta përdorë në shtëpi, e të nesërmen vjen në shkollë dhe e karikon dhe e merr prapë në shtëpi. Në kushtet kur shkolla ishte e mbyllur, ishte e pamundur të përdorëshin ato tableta dhe të shpërndareshin te nxënësit, sepse brenda 24 orëve bëheshin të papërdorshëm.

Sondazhet që kemi zhvilluar ne janë tri: dy sondazhe për arsimin parauniversitar dhe një për arsimin e lartë. Nëse nuk u besoni sondazheve me 320 mijë dhe 220 mijë, merrni sondazhet nga organizata joqeveritare, të cilat bashkëpunojnë me institucionet arsimore. *World Vision* kishte bërë një sondazh pa ia kërkuar ne dhe kishte dalë me rezultate të tjera nga këto që thatë ju. Nuk e di se cilin sondazh citoni ju, por është mirë t’u referoheni sondazheve të zhvilluara nga organizatat që bëjnë këtë...

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, sondazhet tuaja nuk i referohen realitetit të sotëm. E theksoj edhe një herë: tabletat nuk janë shpërndarë sipas shanseve të barabarta te studentët, te nxënësit dhe te maturantët.

**Ismet Beqiraj** – Lëreni ministren të kthejë përgjigje, zonja kryetare!

**Fatjona Dhimitri** – Të lutem shumë!

Ju referoheni *video call*-eve tuaja, zonjë. Nuk më rezulton kështu. Sipas projektit 3,5 milionë euro, ku janë tabletat, zonjë, për projektin e dixhitalizimit të mësimi?

**Ismet Beqiraj** – Lëreni ministren të kthejë përgjigje! Nuk do të bëjmë dialog.

**Besa Shahini** – Janë në shkollë.

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, për procedurë!

**Fatjona Dhimitri** – Tabletat rrinë në shkollë ngaqë nuk kanë karikues. Pra, nuk ka karikues për tabletat, vetëm karikuesi i shkollës mund t'i karikojë ato.

**Ismet Beqiraj** – Kryetare, për procedurë, ju lutem!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, ju lutem! Unë kam bërë disa pyetje.

**Ismet Beqiraj** – Kryetare, për procedurë!

**Fatjona Dhimitri** – Ti do të vijosh pastaj me pyetjet e tua, Ismet! Pyetjet që bëj unë prekin edhe nxënësit e zonës së Ballshit.

**Ismet Beqiraj** – Nuk je në portalin e Partisë Demokratike këtu.

**Fatjona Dhimitri** – Po, zonja Ministre.

**Ismet Beqiraj** – Të lutem!

**Fatjona Dhimitri** – Patjetër! E ke edhe dy orë ministren këtu. Do të flasësh sa të duash.

**Ismet Beqiraj** – Nuk do t'ju dëgjojmë vetëm juve!

**Fatjona Dhimitri** – Po, zonja Ministre!

Jo, do të dëgjojmë propagandën tuaj!

**Ismet Beqiraj** – Jo, do të dëgjojmë ty!

**Fatjona Dhimitri** – Po s'të pëlqeu, ik! Mund të largohesh. Fik kamerën dhe ik!

**Ismet Beqiraj** – E ke ti zakon që braktis detyrën, jo unë.

**Fatjona Dhimitri** – Të thotë të vërtetat e arsimit sot, të flasë për masat që janë marrë sot për nxënësit, të flasë këtu për dështimin e mësimdhënies *online*. Mësimi *online* ka dështuar. Për çfarë më flet mua ajo, për *video call*-et e mësuesve?!

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, nuk do t'ju dëgjojmë vetëm juve!

**Fatjona Dhimitri** – A është e mjaftueshme ajo mësimdhënie, kur mësuesi shpjegon vetëm dy minuta, përmes një *video call*-i? Si mund të përthithet mësimi kështu?

**Ismet Beqiraj** – Asnjë minutë! I ke bërë të gjitha pyetjet!

**Fatjona Dhimitri** – Po, zonja Ministre!

**Ismet Beqiraj** – Jepu kohën e nevojshme edhe anëtarëve të tjerë, që të diskutojnë dhe të bëjnë pyetje!

**Fatjona Dhimitri** – Urdhëroni! Po, zonja Ministre!

**Ismet Beqiraj** – Besa, të lutem, mos i kthe asnjë lloj përgjigjeje! Përndryshe, unë propozoj të mos e zhvillojmë në kushte të tilla mbledhjen e komisionit.

**Fatjona Dhimitri** – Jeni mësuar ju, i merrni vendimet natën!

**Ismet Beqiraj** – Kështu i keni marrë ju, me duar në xhepa.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, urdhëroni!

**Ismet Beqiraj** – Siç bëtë “21 Janarin”, siç bëtë “Gërdecin”!

**Fatjona Dhimitri** – Mos interfero, të lutem!

**Ismet Beqiraj** – Të lutem!

**Fatjona Dhimitri** – Mos interfero! Mbyllini mikrofonin Ismetit, ju lutem!

Zonja Ministre, urdhëroni! Lidhur me alartekstin, ç’ mund të na thoni?

**Ismet Beqiraj** – Na mohoni lirinë e fjalës në komision! Ja çfarë bëni ju!

**Fatjona Dhimitri** – Më rezulton se ju, zonja Ministre, keni vonuar përzgjedhjen e tekstit 2020-2021.

**Ismet Beqiraj** – Keni vrarë më 21 janar, në mes të sheshit! I keni lyer duart me gjak!

**Fatjona Dhimitri** – Më 2020 – 2021 keni përzgjedhur...

**Ismet Beqiraj** – Keni kurajë të ligjëroni. Të lutem, mos bëj pyetje!

**Fatjona Dhimitri** – Po flet budallallëqe, se nuk je fare në dijeni!

**Ismet Beqiraj** – Boll të dëgjuam ty!

**Fatjona Dhimitri** – Po, po, me ty ulet...

**Ismet Beqiraj** – Mos bëj më pyetje! Jepu radhën edhe të tjerëve!

**Fatjona Dhimitri** – Vazhdoni, zonja Ministre, ju lutem!

**Erion Piciri** – Ismet, mos flisni për dhunë, se e keni larë me gjak këtë tokë. Sa na kanë vrarë në dyzet e pesë vjet...

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre!

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, më jep fjalën!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, a mund t’u jepni përgjigje pyetjeve?

**Erion Piciri** – Mehmet Shehu vrau familjen e gjyshit tim...

**Ismet Beqiraj** – Lëri more historitë me gjyshër e stërgjyshër!

**Fatjona Dhimitri** – O Ismet!

Zonja Ministre, ju lutem!

**Ismet Beqiraj** – Lëri gjyshërit e stërgjyshërit, se atë që keni bërë ju për tridhjetë vjet, nuk është bërë kurrë në Shqipëri.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, për alartekstin ç’ mund të na thoni? A ka ndodhur që ju keni urdhëruar shkollat...?

Ismet, mbuloji kohën ministres, derisa të ikë! Mbuloji kohën!

**Ismet Beqiraj** – Nuk do të të dëgjojmë ty tërë ditën!

**Fatjona Dhimitri** – Mbuloji kohën për të dhënë përgjigje, se ajo s’jep dot përgjigje!

**Ismet Beqiraj** – Respekto Rregulloren! Mos e kthe në monolog!

**Fatjona Dhimitri** – Ministrja nuk jep dot përgjigje. Mbuloji kohën!

**Ismet Beqiraj** – Bëj pyetje dhe dëgjo! Mos bëj monolog!

**Fatjona Dhimitri** – Edhe një orë mbeti. Mbuloji kohën!

**Ismet Beqiraj** – Jo, jo, nuk e shfrytëzon ti dot!

**Fatjona Dhimitri** – More, ajo të japë përgjigje! O Ismet, ku ka shkuar projekti 3, 5 milionë euro për dixhitalizimit e arsimit?

**Ismet Beqiraj** – Drejto komisionin, nuk je prokurore, këtë di të them!

**Fatjona Dhimitri** – Ku janë lekët?

**Ismet Beqiraj** – Mos bëj rolin e prokurores, se nuk arrin dot ta bësh!

**Fatjona Dhimitri** – Po, e arrij, e arrij!

**Ismet Beqiraj** – Nuk arrin, jo!

**Fatjona Dhimitri** – Arrij! E vërteta gjithmonë triumfon!

**Ismet Beqiraj** – Nuk e bën dot rolin e prokurores!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, zonja ministre!

Po, do ta bësh ti. Po koha jote mbaroi tani.

**Ismet Beqiraj** – Unë i propozoj komisionit, që ta hedhim në votim. Në këto kushte nuk e vazhdojmë dot mbledhjen.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, të lutem!

**Erion Piciri** – Na jepni neve fjalën, Fatjona!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, të lutem, urdhëroni! Lidhur me alartekstin, më rezulton që ju keni urdhëruar mësues që të vazhdojnë me përzgjedhjen e tekstit sipas dëshirave tuaja, pra të vijojnë me tekstet e vitit 2019-2020, ndërkohë që mësuesit dëshirojnë të punojnë me një lloj tjetër teksti për 2020-2021. Si mendoni ju për këtë? Cila është përgjigjja juaj lidhur me përzgjedhjen e alartekstit? Më rezulton se keni shkelur ligjin për alartekstin.

Po, shkakton të qeshura, normale, sepse çfarë përgjigje mund të jepet!

Meqenëse nuk kemi përgjigje për këtë, kalojmë te pyetja tjetër.

Zonja Ministre, përse ky nxitim në lidhje me hapjen e shkollave për maturantët?

Zonja Ministre, po më dëgjoni? Teknika.

**Besa Shahini** – Me shumë vëmendje po ju dëgjoj, vetëm se kam dalë...

**Fatjona Dhimitri** – Atëherë edhe ne, me shumë vëmendje po presim përgjigjen tuaj, zonjë.

**Besa Shahini** – Jo, ishit duke u zënë mes jush, nuk ishit duke pritur përgjigjen time.

**Fatjona Dhimitri** – Jo, jo, po zihen ata për juve. Urdhëroni! Përse ky nxitim për hapjen e shkollave? A nuk mendoni se fillimisht duhej bërë hapja e shoqërisë, dalëngadalë sektorët e ekonomisë dhe më pas duhet vijuar me hapjen e shkollave për maturantët?

Si e mendoni ju këtë?

Mos ndoshta po i përdorni nxënësit për një eksperiment, për të vërtetuar se sa ata mund t'i rezistojnë virusit?

Si mendoni ju, zonja Ministre, a nuk po e rrezikoni kështu rininë shqiptare me këtë lloj vendimi, i cili bie në kundërshtim me gjendjen e jashtëzakonshme, në të cilën ndodhemi, bie në kundërshtim me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, e cila ndalon grumbullimet në mjedise të caktuara? Ju thoni se keni marrë masa dezinfektuese, higjienizuese, por a jeni e bindur se janë bërë të gjitha dezinfektimet e shkollave dhe, nëse po, ku janë raportet e Institutit të Shëndetit Publik?

Po, zonja ministre.

**Besa Shahini** - Zonja Dhimitri, natyrisht që mendoj se kemi bërë shumë mirë që kemi hapur shkollat, përndryshe nuk do ta kisha marrë këtë vendim. Ne jemi bazuar në sugjerimet më të mira të ISHP-së, i cili na ka sjellë një udhëzues prej 6 faqesh për mënyrën se si mbrohet shëndeti i pjesëmarrësve në këtë proces mësimor, përfshi këtu edhe nxënësit, edhe mësuesit. Po, janë bërë të gjitha dezinfektimet dhe po bëhen rregullisht, se nuk është një dezinfektim që bëhet...

**Fatjona Dhimitri** – Zonjë, ku janë raportet e ISHP-së? A janë testuar mësuesit dhe nxënësit, të cilët dje ishin në shkolla?

**Besa Shahini** – Ju dëgjova me shumë kujdes, prandaj mos më ndërprisni! Nëse keni pyetje shtesë, mi bëni kur të mbaroj, pasi *online* është pak e vështirë të bëhet kjo ndërprerje siç po e bëni, sepse bëhet një kakofoni dhe çakordohet i gjithë diskutimi. Ju lutem, mos më ndërprisni!

ISHP-ja ka sjellë 6 faqe udhëzime se si duhet ta organizojmë punën në shkollë. Hapja e pjesës dhe shkollave ishte jo vetëm vendim i mirë, por i domosdoshëm. Maturantët kishin nevojë të bënin komunikimin e tyre me mësuesit, që të bënin përsëritjet për maturën. Matura nuk ka nevojë të anulohet në kushtet e epidemisë, siç e kemi ne, pra me numrat e infeksioneve, me mënyrën se si po përhapet koronavirusi. Në komunikimin me Ministrinë e Shëndetësisë e të Mbrojtjes Sociale dhe ISHP-në të gjithë e panë të arsyeshme që ne mund ta zhvillojmë këtë

proces të domosdoshëm për mbylljen e arsimit parauniversitar. Pasi të bëjnë provimet, dhe provimet nuk do të bëheshin nëse ne nuk do të kishim mundësi t'i kthenim nxënësit në shkolla, sepse e kërkuan këtë gjë, madje modelet më të mira të vendeve të tjera e thonë këtë, pra përderisa nuk keni mundësi t'i ktheni nxënësit në shkollë, mos i bëni provimet, por nëse i bëni duhet të siguroni kthimin në shkollë për një periudhë së paku 2-3 javore. Ky është vendimi që ne morëm.

Nuk mendojmë që është vendim i keq, përkundrazi mendojmë se është bërë më e mira e mundshme në kushtet në të cilat jemi për t'i respektuar me rigorozitet të paparë të gjitha propozimet dhe sugjerimet e ISHP-së. Besoj se në shkolla nga Ministria e Shëndetit Publik është vendosur një mjek apo infermier, apo stomatolog, të cilët po e ndjekin të gjithë procesin. Higjienizimi nuk bëhet një herë, por çdo ditë, dritaret mbahen hapur gjatë gjithë kohës, të gjitha sipërfaqet pastrohen pas çdo përdorimi, ndërsa dezinfektimi serioz që bëhet në të gjitha ambientet është bërë nga bashkia, para fillimit dhe do të bëhet sipas sugjerimeve të ISHP-së, që kërkon të bëhet çdo dy javë. Në disa bashki do të bëhet çdo javë. Kështu që jemi komplet brenda të gjitha parametrave dhe kemi marrë masat që kjo hapje e pjesshme të mos shkaktojë rrezik në shëndet, duke pasur parasysh se shëndeti është parësor në këtë pikë. Prandaj jemi shumë mirë në këtë pikë, besoj edhe në raportimet e shumë medimeve të ndryshme, që ishin pranë shkollave, gjithçka ka ecur mirë që me ditën e parë dhe kemi mundur ta realizojmë me sukses hapjen e pjesshme të shkollave për maturantët, që kishin nevojë të bënin konsultime me mësuesit e tyre.

Faleminderit!

**Fatjona Dhimitri** – Zonjë, kjo ishte përgjigjja e pyetjeve? Unë pyeta a janë testuar mësuesit dhe nxënësit? Nëse rezulton që një mësues të jetë asimptomatik, por është mbartës i sëmundjes, ekziston rreziku që të kërcënohet jeta e nxënësve të tjerë. Ku janë testet? Normalisht këtë përgjigje duhet ta marrim nga ISHP-ja.

**Besa Shahini** – Këtë desha të them.

**Fatjona Dhimitri** – Pikërisht, por ju nuk e keni bërë këtë kërkesë, si Ministri e Arsimit, për të testuar mësuesit dhe nxënësit.

**Besa Shahini** – As Ministria e Arsimit, as Kryeministria, as institucionet e tjera nuk marrin vendime për çështjet e koronavirusit në vetvete, pra këto sugjerime na i sjell ISHP-ja. Po ta kishte parë ISHP-ja të nevojshme të testoheshin mësuesit dhe nxënësit dhe të bëheshin teste masive, do të bëheshin, por nuk e ka parë të nevojshme me këtë lloj infeksioni që ka ndodhur në Shqipëri, i cili fatmirësisht ka qenë shumë i ulët, për shkak të masave që janë marrë.



**Fatjona Dhimitri** – Nuk ka koordinim mes institucioneve përgjegjëse, mes ministrive përkatëse, pra mes ministrisë suaj dhe Ministrisë së Shëndetësisë?

**Besa Shahini** – Absolutisht që ka.

**Fatjona Dhimitri** – Atëherë pse u hap shkolla, kur nuk janë bërë testet? Përse nuk janë testuar mësuesit dhe nxënësit për të parë nëse janë mbartës apo jo? Zonjë, dje në një gjimnaz mjeku nuk e maste temperaturën e nxënësve, por mësuesi i edukimit fizik dhe termometri shënonte shifra të ndryshme.

**Mirela Kumbaro** – Zonja kryetare, a mund ta marr fjalën?

**Fatjona Dhimitri** – Ju lutem, zonja Kumbaro, do t’jua jap fjalën!

Ndërkohë mësuesi tha “termometër është”. Zonja Ministre, a do të ketë mjekë në gatishmëri të nxënësve?

Mirela, të lutem, të mbaroj me pyetjet! Ministren e keni në dispozicion dy orë, kështu që nëse koha nuk mjafton, do të vijë prapë.

Urdhëroni, zonja Ministre!

Mirela, të lutem, të mos i zëmë kohën e përgjigjeve!

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, kërkoj fjalën për procedurë.

**Fatjona Dhimitri** – Sa herë i keni shkelur procedurat ju!

Urdhëroni, zonja Ministre!

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, jeni në shkelje flagrante të Rregullores.

**Fatjona Dhimitri** – Përse qenkam në shkelje flagrante, se po i kërkoj asaj përgjigjen e një pyetjeje dhe ajo më përgjigjet si dëshiron ose nuk përgjigjet fare!?

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, kur unë e kërkoj fjalën për procedurë, ju jeni e detyruar të ma jepni.

**Fatjona Dhimitri** – Unë do t’ua jap fjalën të gjithëve dhe nëse është e nevojshme, do ta ndaj sot seancën e komisionit në dy pjesë.

**Mirela Kumbaro** – Ju jeni e detyruar të më jepni fjalën tani.

**Fatjona Dhimitri** – Do të ta jap fjalën, pasi të mbaroj zonja ministre me përgjigjen.

**Mirela Kumbaro** – Kjo është një shkelje flagrante. Lexo mirë Rregulloren, që kur një deputet kërkon fjalën për procedurë, jeni e detyruar t’ia jepni.

**Fatjona Dhimitri** – E di shumë mirë. Sa herë i keni shkelur këto procedura ju! Mos ndërhyini dhe lëreni të japë përgjigje, se i mbaron koha dhe ikën.

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, të paktën ruani etikën në komunikim me mua.

**Fatjona Dhimitri** – Po, zonja Ministre.

**Ismet Beqiraj** – Nuk e pranoj këtë dhunë.

**Fatjona Dhimitri** – Ismet, me ty do të bëj seancë dëgjimore më vete.

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, nëse vazhdon kështu, i propozoj ministres ta ndërrojë të gjithë panelin e...

**Fatjona Dhimitri** – Sillu mirë!

**Ismet Beqiraj** – Ministrja nuk është në bankën e të akuzuarve dhe ajo nuk ka përpara një prokuror, edhe pse ëndërron shumë të bëhet, por nuk do të bëhet se do të mbetet në rrugë, sepse ka deficiençë profesionale, nuk respekton Rregulloren. Nëse vazhdon, unë i propozoj komisionit ta ndërpresim mbledhjen dhe t'i kërkojmë ministres ta lërë panelin.

**Fatjona Dhimitri** – Lëreni ministren të përgjigjet.

Nuk ka përgjigje.

Zonja Ministre, lidhur me maturantët që do të lëvizin nga zonat rurale në ato urbane...

Ismet, do të bëj seancë dëgjimore me ty.

**Ismet Beqiraj** – Nuk ka ardhur ministrja të zyra e PD-së që të japë llogari nga fillimi deri në fund, ka ardhur për procedurë. Ti fyen nënkryetaren e komisionit. Kush jeni ju, moj zonjë? Ju keni të drejtë të bëni pyetje, por përgjigjen nuk ka pse ta japë si doni ju!

**Fatjona Dhimitri** – Iku ora, Ismet.

**Ismet Beqiraj** – Përgjigjja do të jepet siç e mendon ai që pyetet.

**Erion Piciri** – Kryetarja po bën ca pyetje shumë të rëndësishme. Lëreni!

**Fatjona Dhimitri** - Ismet, kupto logjikën e pyetjes! Sillu mirë!

**Ismet Beqiraj** – Lërimi ato pyetje, në radhë të parë...

**Fatjona Dhimitri** - Zonja Ministre, lidhur me maturantët që do të lëvizin nga zonat rurale në ato urbane, si do të ruhen rregullat e distancimit social?

**Ismet Beqiraj** – Ju nuk keni monopolin e komisionit, që bëni 100 pyetje!

**Fatjona Dhimitri** – 200 do të bëj, 300, që të sqaroj të gjithë nxënësit dhe prindërit. Keqqeverisja juaj u ka shkaktuar kaq mundim psikologjik dhe shqetësime!

**Ismet Beqiraj** – Mos ia ndërpre fjalën asnjërit. I kërkoj kryesisë së komisionit, nënkryetares dhe sekretarit, si anëtar i komisionit, që mbledhjen të mos e zhvillojmë në këto kushte. Ministrja nuk ka ardhur para prokurores. Kryetarja duhet t'u japë të drejtën deputetëve të tjerë të bëjnë pyetje. Edhe unë kam pyetje për të bërë.

**Fatjona Dhimitri** - Zonja Ministre, lidhur me maturantët që do të lëvizin nga zonat rurale në ato urbane, si do të ruhen rregullat e distancimit social? Kush do ta mbulojë transportin? Ministria, apo prindërit? Ju lutem, zonja Ministre!

**Ismet Beqiraj** – Nuk bëhet monolog këtu.

**Fatjona Dhimitri** – Me ty do të bëj seancë dëgjimore me vete.

Sillu mirë!

**Ismet Beqiraj** – Nuk ke pse bën seancë dëgjimore me mua.

Unë i propozoj komisionit që me një kryetare të tillë, e cila shkel më të dyja këmbët Rregulloren, dhunon lirinë e fjalës së deputetëve, dhunon të drejtën për të respektuar Rregulloren edhe për një kërkesë procedure...

**Fatjona Dhimitri** - Lëre t'u përgjigjet pyetjeve!

**Ismet Beqiraj** – Do t'i kërkojmë grupit tuaj shkarkimin tuaj, madje jemi të vonuar, se po i ktheni mbledhjet në karnavale politike.

**Fatjona Dhimitri** – Nuk je ti shefi i opozitës. Kujdes se mos të shkarkon grupi yt. Do të propozosh ti?

**Ismet Beqiraj** – Po, unë do të propozoj si anëtar komisioni. Ti nuk e meriton atë vend.

**Mirela Kumbaro** – Zonja kryetare, a mund ta marr fjalën?

**Fatjona Dhimitri** – 5 minuta pushim.

**Erion Piciri** – Lëreni ministren, se edhe ajo e maxhorancës është dhe di të flasë, se është shumë e zonja. Mua më vjen mirë që keni zgjedhur një zonjë nga Kosova. Lëreni të flasë, se besoj se i ka të gjitha informacionet.

**Ismet Beqiraj** – T'ua japë edhe kolegëve të tjerë fjalën, edhe juve, të na respektojë! Nuk fillohet mbledhja kështu, se edhe ju keni pyetje edhe unë kam për të diskutuar.

**Erion Piciri** – Sot është dita e ministres.

**Ismet Beqiraj** – Ajo bën pyetje politike, nuk është normale. Turp kush na dëgjon!

**Erion Piciri** – Ismet, unë të respektoj për ato thinja që ke.

**Ismet Beqiraj** – Edhe unë të respektoj për thinjat që ke, por kryetarja po devijon nga rendi i ditës. Doni të bëjmë dy seanca për shembjen e teatrit?

**Erion Piciri** – Jemi brenda rendit të ditës dhe mua më vjen mirë që një zonjë vjen nga Kosova, është një gëzim i madh. PS-ja ka goditur në shenjë duke marrë një ministre nga Kosova. Unë kam parë edhe CV-në e saj, ajo ka një formim në Kanada, në Berlin dhe realisht e respektoj.

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, por nuk ka ardhur para prokurorit.

**Erion Piciri** – Normal që pyetjet që legjislativi duhet të kontrollojë...

**Ismet Beqiraj** – Po bën prokuroren, edhe ju jeni në një mendje me mua, nuk është dialog intelektualësh ky.

*(Pas pushimit)*

**Fatjona Dhimitri** – Jo, e keni shumë gabim, sepse unë kam respekt. Po pres përgjigjet e saj, por ajo nuk përgjigjet.

**Mirela Kumbaro** – Kemi 70 minuta që ju dëgjojmë vetëm ju.

**Fatjona Dhimitri** – Çështjen e saj e mbulon Ismeti, e mbuloni ju me procedurën dhe e mbulon tjetri, ndërkohë që ajo po rri.

**Mirela Kumbaro** – Keni 70 minuta që flisni vetëm ju. Në këtë moment unë propozoj të marrin fjalën edhe deputetët e tjerë! Boll ju!

**Fatjona Dhimitri** – Po, patjetër, do ta marrin fjalën.

**Ismet Beqiraj** – E kërkoj unë fjalën.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, në lidhje me masat e marra për maurantët, të cilët do të udhëtojnë në distanca më të largëta nga zonat rurale drejt atyre urbane, si do të ruhen rregullat e distancimit social? A do të zbatohen ato? Kush do ta financojë transportin e tyre? Do ta financojë ministria apo prindërit e tyre? Po në rastet e familjeve me të ardhura minimale, kush do ta financojë?

Urdhëroni, zonja Ministre!

Besoj se e dëgjuat pyetjen.

**Besa Shahini** – A do të më lejoni të përgjigjem, apo do të më ndërprisni përsëri?!

**Fatjona Dhimitri** – Urdhëroni!

**Besa Shahini** – Për nxënësit që jetojnë larg dhe e kanë të pamundur udhëtimin, sikurse edhe më parë, transporti i tyre financohet nga Ministria e Arsimit. Është një numër i vogël i nxënësve që kanë këtë problematikë. Për nxënësit e shkollave private, të cilëve mund t'ua organizojë vetë shkolla transportin, kemi bërë të gjitha përgatitjet me Ministrinë e Brendshme për t'i lejuar furgonat dhe këta transportues që të kenë mundësi t'i çojnë nxënësit nëpër shkolla, gjithmonë duke ruajtur distancimin social, pra nxënësit nuk mund të rijnë afër njëri-tjetrit. Nxënësit, të cilët kanë udhëtuar më parë me makina private, do të vijojnë të udhëtojnë me makina private dhe prindërit e tyre do të rimbursohen duke ruajtur distancimin social. Pra, rregulli është që në një makinë mund të ulen dy persona në mënyrë diagonale me njëri-tjetrin. Një grup i vogël i nxënësve, të cilët kanë jetuar më parë në konvikte, nuk mund ta vijojnë mësimin në shkollë dhe po e vijojnë mësimin *online*. Kjo gjë është përgatitur më parë në komunikime ditore me familjet e nxënësve dhe me nxënësit, në mënyrë që të gjendet zgjidhja më e mirë. Një pjesë e nxënësve që janë paraqitur, por nuk duan të kthehen në shkollë, nuk kanë nevojë për këto përgatitje dhe do të vijnë vetëm për provimin maturës. Edhe kjo është lejuar, sepse nuk e kemi të obliguar kthimin e nxënësve në shkolla, nëse ata nuk e shikojnë të

arsyeshëm ta bëjnë këtë. Kështu që të gjitha këto elemente janë adresuar në kohë dhe pjesa e nxënësve që janë në shkollë, do të vijojnë ta ndjekin mësimin për 3 javë, kurse pjesa tjetër e nxënësve, të cilët kanë vendosur të mos vijnë në shkollë dhe ata që nuk e kanë të mundur, do ta bëjnë mësimin në kushte shtëpie. Pra, e gjitha kjo është planifikuar me kohë dhe po vijon siç duhet edhe mësimi *online*, duke ndjekur transmetimet në Televizionin Shqiptar (për maturantët është pasuruar me zgjidhje të problemave në matematikë dhe shkencë, ndoshta e keni parë në Radiotelevizionin Shqiptar) dhe përmes mëimit *online* me mësuesit e tyre, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme.

Gjithashtu, janë botuar programet e reja për provimin e maturës me tema të hequra, sepse, ashtu siç e dini nga komunikimet publike që ne kemi bërë gjatë gjithë kësaj kohe, kemi hequr nga provimi i maturës temat që janë zhvilluar në kushte shtëpie. Mendohet se nuk është e drejtë të pyeten për këto tema, sepse janë tema që shumica e nxënësve i kanë marrë, por një pjesë e vogël ndoshta nuk i ka bërë në mënyrë të drejtë dhe cilësore. Kështu që janë hequr një pjesë e temave dhe programet e reja janë botuar në kohë dhe nxënësi e di si duket testi, cilat janë temat që janë në test dhe cilat janë rregullat që duhet të ndjekë për ta bërë provimin e maturës. Mendoj se sivjet, si kurrë më parë, nxënësit janë plotësisht të përgatitur për provimin e maturës dhe gjithçka do të shkojë mirë.

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, ku do t'i realizoni provimet e maturës? Nuk e shikoni mundësinë që provimet të realizohen edhe në stadione të hapura? Kush do t'i monitorojë këto provime? Mësuesit e shkollës?

**Besa Shahini** – Zonja Dhimitri, jua kemi dërguar të gjitha dokumentet që përcaktojnë se si do të zhvillohet provimi i maturës. Nuk po organizohet për herë të parë provimi i maturës. Kështu që nuk po i kuptoj pyetjet tuaja. Provimi administrohet nga një grup....

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, nuk organizohet në kushte të tilla. Provimet e maturës nuk janë realizuar ndonjëherë në kushte të tilla. Vitet e tjera nuk kemi qenë në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, nuk kemi qenë në kushtet e pandemisë globale dhe maturantët i zhvillonin provimet në kushte normale nëpër salla, siç janë realizuar. Pse nuk e shikoni mundësinë që provimet të zhvillohen edhe në stadione të hapura, ku distanca ndërmjet maturantëve do të jetë më e madhe?

**Besa Shahini** – Stadione të hapura, në qiell të hapur...

**Fatjona Dhimitri** – Ku mendoni ju t'i realizoni? Në shkollë?! Në qiell të hapur?! Nuk do të luajmë sport, zonja Ministre!

**Besa Shahini** – Po për çfarë është stadiumi i hapur tjetër, në qoftë se nuk është stadiumi i futbollit, sepse nuk e kuptoj?!  
21

**Fatjona Dhimitri** – Ku mendoni ju t’i realizoni, nëpër klasa, si e keni menduar?

**Besa Shahini** – Zonja Dhimitri, edhe një herë po ju kthej përgjigje për pyetjet tuaja. Në secilën klasë sot që janë kthyer maturantët, janë 10 deri 12 nxënës në klasë. Kjo siguron distancimin social mes tyre. Provimi i maturës do të zhvillohet në të njëjtën klasë, ku nxënësi ka edhe emrin të afishuar në derën e klasës. Pra, nxënësi në të njëjtën bankë, ku është duke u ulur gjatë këtyre 3 javëve që po bën përsëritjet, do të bëjë edhe provimin e maturës. Sivjet kjo është risia, sepse në të kaluarën jemi përpjekur që nxënësit t’i vendosim nëpër salla më të mëdha, kurse tani do t’i vendosim në klasë. Administrimi bëhet nga administratorët. Administratorë janë një grup mësuesish, drejtues të shkollave e të tjerë që koordinohen në mënyrë që të bëjnë administrimin. Natyrisht, diku nuk do të ketë mësues të klasës që do të bëjnë administrimin. Pra, nuk është mësues i klasës që administron provimet e maturës për nxënësit. Kjo procedurë është e rregulluar, është shkruar dhe ua kemi dërguar udhëzimin. Kështu që nuk e kuptoj specifikisht pyetjen, sepse nuk ka ndonjë ndryshim; pjesa e administrimit, është siç ka qenë më parë. Edhe më parë për çdo 15 deri 20 maturantë ka qenë një administrues, kurse tani do të kemi një administrues për çdo klasë. Pra, nuk po e kuptoj këtë pjesë të shqetësimit, brengës apo pyetje që po bëni. Do t’ia kaloj fjalën Zamira Gjinit, sepse është në komisionin e maturës dhe e ka menduar me detaje zhvillimin e provimit të maturës, dhe mund t’ju kthejë përgjigje edhe për këto pyetje specifike që, ashtu siç thashë, nuk ka ndonjë ndryshim sivjet nga vitet e mëparshme.

**Fatjona Dhimitri** – Po ua jap fjalën kolegëve të tjerë, por vijojmë një herë me pyetjet për arsimin parauniversitar dhe më pas do të vijojmë me pyetjet për arsimin universitar. Pra, po e ndajmë në dy pjesë mbledhjen e sotme të komisionit.

Erion, keni kërkuar fjalën.

Urdhëroni!

**Erion Piciri** – Mirela, jua lë me kënaqësi fjalën!

**Mirela Kumbaro** – Zoti Piciri, ju falënderoj, kam një pyetje të shkurtër, por më parë kam një koment procedural.

Zonja kryetare, në seancë plenare, ju e keni parë që diskutohet sipas disa rregullave shumë strikte: u kufizohet koha që nga Kryetarit të Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetarëve të komisioneve dhe deputetëve. I njëjti rregull funksion edhe në mbledhjet e komisioneve. Domethënë, nuk do të thotë se kryetari i komisionit mund të bëjë çfarë të dojë dhe, nga dy orë që ne kemi në dispozicion, të marrë treçerekun e kohës, të konsumojë të gjitha pyetjet e tija, më pas çfarë të mbetet për deputetët.

Së pari, është mungesë respekti për kolegët, pavarësisht se të cilit krah politik janë.

Së dyti, është mungesë respekti për Rregulloren. Pra, e fillova nga respekti njerëzor, sepse e kam shumë të rëndësishëm dhe më pas ai ligjor, të cilin ju duhet ta dini mirë.

Më pas është shpërdorimi i kohës dhe joefikasiteti.

Kështu që, në këtë drejtim, ju lutem, zonja kryetare, të jetë absolutisht hera e fundit që ne thërrasim dikë në dëgjuesë, ju e merrni fjalën, më pas e mbani derisa t'ju dojë qejfi dhe në mënyrën më arbitrare dhe brutale ua ndërprisni të gjithëve kërkesën për ndërhyrje për procedurë, për të vënë këtë rregull që na e detyron Rregullorja dhe nuk është dëshira jonë. Kjo gjë më duket tmerrësisht abuzive, nuk duhet të ndodhë më, ose këto mbledhje nuk do të zhvillohen më në rrethana të tilla.

Po kaloj te pyetja ime. Zonja Ministre, ndoshta e kam pyetjen për zotin Rrumbullaku, meqenëse është marrë drejtpërdrejt me universitetet. Në kuadrin e autonomisë universitare, a kanë kompetencë universitetet t'i organizojnë vetë format e tyre të mësimi *online* dhe të marrjes në provim, duke respektuar rregulla strikte, të cilat ju shumë saktë na i keni çuar në udhëzime, qoftë për maturat, qoftë për mënyrën se si bëhet mësimi, apo është e unifikuar për të gjitha universitetet publike dhe private njësoj mënyra e organizimit të mësimi *online* dhe të marrjes në provime? E them këtë, duke u nisur nga eksperiencia që janë përpjekur të ndjekin vendet e tjera, të cilat janë në të njëjtat kushte. Në fakt, ne nuk po i shpikim udhëzimet që ju na i keni sjellë, të cilat as ju nuk i keni shpikur, sepse jua ka dhënë Instituti i Shëndetit Publik brenda kuadrit të vendimmarrjes të taskë forcës kombëtare, pra pak a shumë janë të njëjta. Nuk është vetëm Shqipëria që e ka filluar mësimin, por, për informacion të kolegëve dhe të zonjës kryetare, që u shqetësua për shëndetin, janë shumë vende, të cilat në forma të ndryshme e kanë hapur, madje vende shumë më të rënuara e kanë filluar procesin mësimor, siç është, për shembull, Franca.

Dua të di vetëm...

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Kumbaro, Franca i hapi shkollat, por u verifikuan nxënësit mbartës të sëmundjes, të cilët kishin infektuar edhe nxënës të tjerë në shkollë. Domethënë, ky është modeli që duhet të ndjekim edhe ne, këtë model kthimi në auditorë apo në shkolla duhet të marrim?!

**Mirela Kumbaro** – Zonja Dhimitri, a ka mundësi, sepse nuk po flas me ju, por po flas me të ftuarit. Bashkë më pas dalim dhe komentojmë se çfarë po bën Franca dhe Italia, sepse edhe unë e di se çfarë po bëjnë ata.

Pyetja që unë kam: deri ku është kompetenca e Ministrisë së Arsimit që po e rregullon këtë gjë për universitetet dhe sa universitete kanë hapësirën e tyre për ta vetorganizuar këtë punë?

Faleminderit!

**Besa Shahini** – Faleminderit, për pyetjen!

Universitetet kanë 100% hapësirë për ta organizuar këtë pjesë të punës. Ne thjesht kemi nxjerrë një urdhër, me të cilin ju kërkojmë që të marrin masa për të organizuar punën, në mënyrën më të mirë të mundshme. Pra, disa universitete i kanë mbyllur plotësisht disa lëndë *online* dhe studentët janë të kënaqur me punën e realizuar *online*. Ka disa lëndë ku nuk kanë nevojë të bëjnë punë laboratorike apo nuk kanë nevojë të kthehen në auditorë dhe kanë mbyllur të gjithë procesin. Kështu që thjesht ata do të vijojnë t'i mbyllin notat dhe provimet përmes eseve e të tjera. Ka disa lëndë të tjera, ku kërkohet ose punë laboratorike, ose përsëritje të ndryshme. Ajo që kemi bërë ne, pra që na takon neve si Ministri Arsimit, është se kemi kërkuar që universitetet të marrin masa për të organizuar punën, duke i dërguar edhe udhëzimin e ISHP-së, u kemi kërkuar të sigurojnë distancim dy metra, pastrim të ambienteve çdo ditë, higjienizues, maska e të tjera dhe i kemi pyetur se si mund t'i kthejnë studentët pjesërisht në auditorë dhe si mund t'i organizojnë provimet në këto kushte. Pra, ne nuk kemi dorë në organizimin e kësaj, por jemi thjesht institucion koordinues dhe, në një farë mënyre, mbledhim informacion për rastet që duhet të raportojmë te ju dhe të kemi edhe një burim të përbashkët informacioni për ju.

**Mirela Kumbaro** - E kuptova.

Faleminderit!

**Fatjona Dhimitri** - Zoti Piciri, fjala për ju.

**Erion Piciri** - Faleminderit!

Kam një pyetje për ministren dhe një koment të shkurtër. Dua t'i drejtohem direkt zonjës Kumbaro. Unë nuk jam i batutave, megjithëse e njoh mirë kulturën bizantine të humorit.

**Mirela Kumbaro** – Nuk ju akuzova për një gjë të tillë dhe as më shkoi në mendje fare!

**Erion Piciri**- Nuk ka problem, unë ju jap përgjigje siç e mendoj.

Ju lutem, më lini të flas, sepse unë ju lashë edhe radhën, edhe konceptin!

**Mirela Kumbaro** - Ta sqarojmë këtë keqkuptim, sepse unë nuk e kisha fare...

**Erion Piciri** - Sot në këtë mbledhje komisioni ka dy shqetësime.

Shqetësimi i parë lidhet me arsimin dhe do t'i bëj pyetje zonjës ministre, ndërsa shqetësim tjetër lidhet me një agjendë qytetare të trashëgimisë tonë kulturore.

Pyetja e parë për ministren është: a ka një mbulim ligjor forma *online* dhe a duhet të ndërhyhet nga pikëpamja ligjore? Ky është një shqetësim i shfaqur nga kolegët e universitetit, sikur ky proces është pak i pambuluar, sepse në Shqipëri nuk lejohet forma *online* e mësimit. Kjo është një pyetje shumë e sinqertë dhe pa ndonjë lloj tendence.



Në qoftë se më lejoni, pasi jemi vetëm dy ditë larg të një prej datave më të shënuara në historinë e kombit tonë dhe 17 maji është një ditë e zezë, sepse është goditur kultura kombëtare, meqenëse mbledhjet e komisionit transkriptohen, dua të jap një deklaratë që realisht mund t' i shkoj deri në fund. Një minoritar ekstremist, i një prej minoriteteve shqiptare që kemi sot në Shqipëri, një antishqiptar, ka shembur godinën bazike të kulturës shqiptare, që lidhet me Teatrin Kombëtar. Ky është një fakt shumë i rëndë. Këtë e ka bërë edhe Enver Hoxha, i cili ka fshirë gjurmë të tëra të historisë kristiane dhe të feve të tjera në Shqipëri, por në vitet e Shqipërisë moderne ky është një ndër aktet më të rënda antikombëtare. Kjo nuk është një lojë fjalësh, por ka goditur në zemër të kryeqytetit e të kulturës sonë kombëtare dhe ka fshirë 80 vjet të Teatrit Kombëtar shqiptar. Unë, me sa fuqi të kem në këtë parlament, do të kërkoj shkarkimin e këtij njeriu. Mbajeni mend, është ekstremist i një minoriteti, që ka humbur gjuhën dhe kulturën e tij dhe po shkatërron gjuhën dhe kulturën e kombit tonë!

Meqenëse ministren e kemi nga Kosova, dua t' i them që për këtë kishte një ekspozim të jashtëzakonshëm të vëllezërve tanë kosovarë. Mua më pëlqen shumë që ministrja jonë e Arsimit është nga Kosova, sepse është nga vendi i Rugovës, nga vendi i një ndër lidhjeve më të mëdha që nga koha e Skënderbeut. Unë nuk dua ta polemizoj. Më vjen mirë që është diçka e tillë, por të godasësh kulturën kombëtare shqiptare... Dua t' u them socialistëve që e mbështesin, por edhe Kryeministrit të vendit, që sot nëpër fshatrat e bregut edhe hauret po rikonstruktohen dhe të godasësh në zemër të Shqipërisë Teatrin Kombëtar është një nga aktet më barbare të historisë moderne! Pas Enver Hoxhës, i cili ishte një kloun që merrte ide nga Bashkimi Sovjetik dhe Kina, ky është i dyti që po shkatërron mu në zemër të Shqipërisë kulturën tonë kombëtare. Me këtë logjikë të shumicës ju mendoni se mund të shkatërroni nesër edhe "Mësonjëtorën", sepse mund të gjeni argumente pa fund, si, për shembull: "Shqipja u shkrua në 1900-ën, nuk kemi pse ta mbajmë një objekt të tillë", por kombi ynë është një komb i mbijetesës dhe i luftërave të mëdha. Na goditën osmanët dhe s'na lanë gjuhën dhe kulturën, por ta dini... Albin Kurti e krahasoi me Millosheviçin, po, është, dhe e nënvizoj diçka të tillë, kemi të bëjmë me një personazh që ndoshta e flet shqipen, ky është ai i batutës, por është njeriu më tendencioz ndaj kulturës sonë kombëtare. Ai po shkatërron në sport dhe në kulturë gjurmët e themelimit të shtetit shqiptar. Unë nuk dua ta përmend minoritetin, sepse në jetën time kam njohur shumë zotërinj nga ai minoritet, që e duan Shqipërinë dhe kanë dhënë shumë për Shqipërinë, por ky është një minoritar ose një miks minoritetesh dhe kjo është ajo që në një moment të lidhshëm thuhet që edhe influencon në vendimmarrjet e tij. Unë e kuptoj fare mirë që edhe në raportet ndërkombëtare thuhet që shqiptari për grupin shkel rregullat dhe principet universale, por ky lloj njeriu ka goditur në zemër të kulturës shqiptare dhe kjo është e

pafalshme. Kjo nuk lidhet me partitë, të majta apo të djathta, sepse e majta dhe e djathta shqiptare ndoshta nuk kanë thellësinë të kuptojnë institucionet bazike të shtetit shqiptar, pasi edhe Partia Demokratike e kishte lënë jashtë atë objekt, por këtu flasim për diçka më shumë, për themelet e shtetit dhe për disa gjurmë në historinë tonë kombëtare, që i kemi të trashëguara.

Ne jemi një komb i vjetër, por na mungojnë disa elemente, që na lidhin me ilirët dhe me shumë elemente të botës moderne, të cilat kur vendosen, nuk mund të shkatërrohen kurrsesi. Bota bën restaurimin e ndërtesave, i fshin të gjitha, por ruan fasadën. Unë kam eksperiencë në vendet e Lindjes dhe në antishqiptarizmin, ku kam gjetur shumë filozofi dhe koncepte të tilla. Këta jetojnë me disa ide, që ndoshta Ali Pasha u dogji një fshat dhe duan të djegin kulturën dhe trashëgiminë kulturore shqiptare. Ftillohuni! Kanë shkatërruar dhe po shkatërrojnë. Kjo nuk është çështje partish. Unë s'jam partiak dhe partia më vjen ngushtë në filozofinë time. Unë jam një njeri që e dua kombin tim dhe kam një koncept universal. I thashë një herë një kryetari partie që partia për mua është si letër higjienike; nuk funksion për mua partia, por koncepti i saj. Po ju them që keni goditur në zemër të Shqipërisë dhe po shkatërroni elementet bazike. Kjo është si shembulli i "Mësonjëtores" dhe me logjikën e shumicës ju mund të shkatërroni sot kala.

**Mirela Kumbaro**- Jeni jashtë temës së komisionit.

**Erion Piciri**- Mirela, ka dy elemente të rëndësishme politika: agjendën qytetare dhe agjendën e komisionit, ku agjenda qytetare të bën të flasësh dhe të mendosh për çështjet bazike të këtij kombi. Jam shumë i trishtuar që nga dita e dielë, sepse nuk e prisja nga ky që keni në krye të qeverisë, i cili është djalë inteligjent, por unë them që ka një urrejtje ndaj kombit shqiptar...

**Mirela Kumbaro** – Ju lutem, kemi kohën e kufizuar për t'i bërë pyetjet dhe, sinqerisht, duke vlerësuar...

**Erion Piciri** - Pyetjen dhe komentin e bëra, prandaj po tërhiqem. Në dy minutat që do të më jepen në parlament, do ta them edhe një herë diçka të tillë.

Ju falënderoj!

**Mirela Kumbaro** - Patjetër, por problemi është se e kemi kohën e kufizuar lidhur me...

**Erion Piciri** - Mirela, tërhiqem!

Unë thashë një ide timen, sepse ky është...

**Mirela Kumbaro** - Zoti Piciri, unë ju falënderoj për sinqeritetin, por kam vetëm merakun se koha ikën dhe ka shumë kolegë, të cilët...

**Erion Piciri** - U tërhoqa.

Ju falënderoj që më dhatë mundësinë të flas!

**Ismet Beqiraj** - Kryetare, për procedurë.

**Mirela Kumbaro** – Kërkojani fjalën kryetares për procedurë.

**Ismet Beqiraj** – Të bëjmë pyetjet për ministren, pastaj të kthejë përgjigje. Të mos i bëjmë në mënyrë individuale.

**Fatjona Dhimitri** - Zoti Piciri, a keni më pyetje për zonjën ministre?

**Ismet Beqiraj**- Zonja kryetare, ju lutem, unë sugjeroj...

**Fatjona Dhimitri**- Zoti Ismet, do ta merrni fjalën edhe ju, edhe zoti Nasufi, edhe zonja Mirela dhe të gjithë.

**Ismet Beqiraj**- Dakord, por të bëjmë pyetje...

**Fatjona Dhimitri** -Zoti Beqiraj, urdhëroni!

**Ismet Beqiraj** - Unë dua të falënderoj zonjën ministre, gjë që e bëri edhe zoti Piciri, për të gjithë punën e madhe, që ka qenë pjesë e programit të emergjencës së fatkeqësisë kombëtare, ku arsimit parauniversitar brenda dy ditësh hyri (nuk po themi që dhënia e mësimit *online* është një risi në të gjitha ciklet e arsimit) në hulli normale për t'i dhënë kohën e nevojshme një brezi të tërë të rinjsh, deri te fëmijët! Kjo është një praktikë dhe risi jo vetëm për ministren, e cila duhet përshëndetur, por unë gjej rastin të falënderoj dhe të përshëndes të gjithë arsimtarët e të gjitha niveleve, që nga parashkollori, parauniversitari dhe të gjitha institucionet e larta, që e përballuan me sukses! Në kushte normale, si çdo gjë tjetër, ka defekte plot, por qëllimi ishte për të mos djegur vitin shkollor, për t'u dhënë mundësi t'i relaksojmë me dije dhe jo me stres, jo me mlllef dhe jo me vrer politik në këtë periudhë. Kjo metodë, në kushtet e vendit tonë, ka qenë një nga metodat më efektive dhe ka qenë një kapital. Jam dakord me ministren, e cila tha në fund të fjalës së saj që ne duhet të parashikojmë jo vetëm pandemitë, por edhe për fatkeqësitë e tjera natyrore, se si t'i zhvillojmë në kushtet, siç ishte rasti i tërmetit, për të cilat nuk jemi të imunizuar në vitet që do të vijnë, sigurisht që do të ketë, ndaj kjo është një eksperiencë e madhe.

Për ta mbyllur me pjesën e parë, kam dy pyetje. Pyetjen e parë e kam në lidhje me institucionet e arsimit të lartë. Cili është sugjerimi juaj (sigurisht është liria akademike dhe autonomia e universiteteve, e institucioneve të arsimit të lartë) lidhur me një komponent shumë të rëndësishëm, ndoshta specialistët që ka ministria, zoti Rrumbullaku, mund të na kthejë një përgjigje, që janë praktikat profesionale? Unë mendoj se këto kërkojnë domosdoshmërisht aplikimin e sistemit dual ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, kompanive publike dhe institucioneve publike. Këtu kam parasysh bashkitë si institucione të larta, ku realizohen praktikat profesionale. Kjo është pyetja e parë, thjesht për të sugjeruar. Mirë për laboratorët,

për seminarët është dhënë koha dhe janë dhënë orientimet, por ky komponent nuk është prekur diku, ose ndoshta unë nuk e kam perceptuar tamam.

Pyetja e dytë: duke parë edhe trendin e infektimit nga COVID-19 për një periudhë 2-3-javore, ta zëmë brenda qershorit, çfarë është menduar për afatet e mundshme për zgjedhjet në universitete? Ju tashmë e dini që mandati i tyre ka mbaruar, por në këtë periudhë janë edhe problemet e provimeve e të tjera, por paralelisht duhet menduar edhe për këtë situatë. Sigurisht, kjo duhet të bëhet në një kohë që të mos krijohen drama shëndetësore, këtë nuk e diskutojmë. Por, duke pasur frikën që në shtator, sikurse u tha, mund të rikthehet faza e dytë e pandemisë, unë jam plotësisht dakord që kjo procedurë të shtyhet. Unë do të sugjeroja që edhe me akte ligjore, të cilat t'i kalojmë në parlament, ky afat le të shtyhet dhe të bëhen ndryshimet përkatëse.

Faleminderit!

**Fatjona Dhimitri** – Urdhëroni, zonja Ministre!

**Besa Shahini** – Faleminderit për pyetjet!

Unë do t'u përgjigjem dy prej pyetjeve, më pas besoj se zoti Oltion Rrumbullaku apo edhe zonja Zamira Gjini mund të kthejnë përgjigje për pyetjet e tjera.

Mësimi *online* nuk ndalohet nga ligji i arsimit të lartë, nga rregulloret e ndryshme dhe aktet nënligjore që dalin nga ligji. Patjetër që është e mundur të bëhet mësimi *online*, sidomos në mënyrën që po bëhet këtu. Pra, ne nuk po e organizojmë mësimin në universitetet tona plotësisht *online*, më pas jepet diploma vetëm nga mësimi *online*, por është një *blended learning*, një mësim i përzier, ku një pjesë e vogël e leksioneve janë *online*, ndërsa pjesa kryesore e provimeve dhe e punëve të tjera zhvillohen nëpër universitete. Pra, që të hiqet ky shqetësim nga diskutimi, mund të them se nuk e kemi të ndaluar të zhvillojmë mësimin *online*, por nuk është tamam i normuar që t'i orientojë të gjitha universitetet ta zhvillojnë në kushte shtëpie në mënyrë të harmonizuar. Unë nuk e di sa është e nevojshme realisht, sepse universitetet kanë lirinë që ta organizojnë në mënyrën më të mirë të mundshme këtë gjë. Ndaj, në takimet e rregullta që kemi pasur me rektorët e universiteteve publike, por edhe me rektorët e universiteteve private ne kemi kërkuar që të na sjellin eksperiencat e tyre më të mira dhe, nëse kanë nevojë, të bëjmë një lloj normimi, duke luajtur gjithmonë rolin e koordinatorit me udhëzues, pra jo nëpërmjet urdhrave, rregulloreve apo VKM-ve, sepse nuk na takon neve, por të nxjerrim një udhëzues, nëse ata e shikojnë të nevojshme, për të organizuar punën e tyre nga vjeshta e tutje. Ky është diskutimi që ka ndodhur tani dhe puna që po bëhet tani. Janë dy-tri modele të mira të universiteteve Perëndimore, të cilat po e zbatojnë tashmë mësimin e përzier, *blended learning*, edhe jashtë kushteve të jashtëzakonshme.

Elementi kyç është që leksionet, që kërkojnë salla të mëdha me shumë studentë, me 200 apo 300 studentë nëpër auditorë, do të zhvendosen totalisht *online*, ndërsa puna në grup dhe në laboratorë do të bëhet në universitete. Ky është pak a shumë edhe modeli që besoj se është zhvilluar në disa nga universitetet në Shqipëri dhe po na i sjellin si propozim që ta koordinojmë këtë lloj forumi, ta diskutojmë dhe t'i orientojmë të gjitha universitetet për organizimin e një gjëje të tillë edhe në vjeshtë. Pra, auditorët e mëdhenj, që kërkojnë një numër të madh të studentëve, të njëjtin ambient ta zhvendosin *online*, ndërsa pjesa e punës në grup dhe pjesa e punës në laboratorë të mbahet në universitete. Këto janë thjesht diskutime fillestare, pra nuk është mbyllur ky lloj koordinimi, që të ketë një udhëzim të përgjithshëm për universitetet.

Për sa u përket zgjedhjeve, natyrisht ne e shtymë datën e zgjedhjeve një herë për shkak të pandemisë dhe për shkak të pamundësisë së studentëve që të ishin nëpër auditorë për të votuar. Që nga protesta e studentëve ne kemi zhvilluar dhe kemi përmbyllur marrëveshjen “Pakti për universitetin”, që e kemi me studentët, ndaj është e domosdoshme që zgjedhjet të bëhen në kohën kur edhe studentët mund të votojnë dhe mund ta shprehin vullnetin e tyre jo vetëm për udhëheqësit e universiteteve, fakulteteve dhe departamenteve, por edhe për përfaqësuesit e tyre në universitete. Ndaj, ne duhet të presim dhe në momentin e parë kur ekziston mundësia që studentët të udhëtojnë lirshëm, që të mund të vijnë fizikisht të votojnë, që të shpallim edhe datën e zgjedhjeve. Ministria e Arsimit nuk ka asgjë tjetër në dorë përveç shpalljes së datës për zgjedhjet. Natyrisht, zgjedhjet janë organizuar nga Ministria e Arsimit, por ato janë obligim i vetë universiteteve. Ne jemi duke e parë situatën me shumë kujdes dhe po presim informacion edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe nga Instituti i Shëndetit Publik që zonat ku janë universitetet të hiqen nga zona e kuqe, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të udhëtojnë dhe të kemi një prezencë më serioze të studentëve nëpër auditorë. Patjetër që nuk do të presim deri në vjeshtë, nëse ekziston një rrezik që të kemi një valë të dytë të pandemisë, kur do t'i mbyllim përsëri institucionet arsimore. Pra, duhet të bëjmë një kalkulim të balancuar, duke parë situatën nga dita në ditë që të shpallim datën e zgjedhjeve. Ajo që ka ndodhur në të gjitha universitetet pa përjashtim është se ka ecur para procesi i organizimit të zgjedhjeve. Për shembull, Universiteti Politeknik kishte ndërruar edhe rregulloren, në mënyrë që të jetë gati plotësisht për organizimin e zgjedhjeve në momentin kur do të shpallen këto data. Ne duhet të sigurohemi që datën ta shpallim pak më shumë se një muaj përpara, në mënyrë që të gjithë kandidatët të kenë mundësi të bëjnë fushatën e tyre dhe të ketë zgjedhje sa më të mira dhe të drejta për udhëheqësit e universiteteve, por edhe për përfaqësuesit e studentëve në universitete.

Unë do t'ia jepja fjalën zotit Oltion Rrumbullaku për pjesën e praktikave dhe për mënyrën se si kanë vendosur universitetet ta organizojnë në kushtet e jashtëzakonshme në të cilat po punojnë.

**Oltion Rrumbullaku** – Faleminderit!

Siç e tha edhe ministrja, ne kemi bërë shumë takime dhe diskutime me rektorët gjatë javës së mëparshme. Një nga çështjet e ngritura ka qenë edhe çështja e praktikave mësimore. Kuptohet që janë dhënë disa zgjidhje...

**Fatjona Dhimitri** – Zoti Rrumbullaku, a mund ta ngrini pak zërin, ju lutem, pasi të paktën këtu tek unë nuk dëgjoheni? Nuk e di nëse dëgjoheni te deputetët e tjerë.

**Oltion Rrumbullaku** – Atëherë, siç e tha edhe ministrja, ne kemi bërë shumë takime dhe diskutime të herëpashershme me rektorët e universiteteve. Kuptohet që një nga çështjet e ngritura ka qenë edhe çështja e praktikave mësimore, ku janë dhënë disa zgjidhje. Një nga zgjidhjet, për shembull, është që praktikat që kanë qenë në vazhdimësi, do të konsiderohen të realizuara. Patjetër për pjesën e praktikave mësimore Universiteti i Mjekësisë, bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Shëndetësisë kanë kërkuar që, nëse hapen pak më shumë spitalet, duke filluar që nga muaji qershor, të krijohet mundësia që studentët t'i bëjnë praktikat e shkencave mjekësore në qytetet ku janë. Po ashtu, për pjesën e praktikave të ndryshme që kanë lidhje me mungesën e mësuesve, vetë pedagogët dhe studentët të organizohen, qoftë nëpërmjet incizimeve apo nëpërmjet formave të tjera. Kështu, patjetër që edhe periudha e muajve qershor dhe korrik, sikundër edhe muajt shtator dhe tetor, janë momente ku mund të realizohen praktikat e mbetura qoftë në forma ndërinstitucionale, në formën e bashkëpunimit me institucione apo biznese dhe praktikat në universitete, ku, në bazë të degëve përkatëse, do të gjejmë mënyra për t'i sistemuar.

Faleminderit!

**Fatjona Dhimitri** – Po, zonja Gjini.

**Zamira Gjini** – Përshëndetje!

Lidhur me tekstet shkollore, do të doja të ndaja me ju që në këtë proces ku ne kemi vendosur ta zhvillojmë këtë vit mësimor, që, sikurse e thatë edhe ju në fjalën tuaj, është një vit i jashtëzakonshëm dhe në kushte të jashtëzakonshme, ne si Ministri e Arsimit dhe komisioni që merret me procesin e zgjedhjes së teksteve duhej të merrnim një vendim, për shkak se ky proces i binte që të ndodhte në kohën kur mësuesit nuk ishin në mjediset e shkollës dhe është një proces që kryhet në shkollë. Ndaj, ne, si komision, në komunikim edhe me botuesit, ndërkohë që ligji i arsimit parauniversitar thotë që procesi i përzgjedhjes së teksteve në shkolla bëhet me udhëzim të ministrit, në këto kushte të reja të jashtëzakonshme, morëm një vendim

dhe doli udhëzimi i ministrit, i cili përcaktonte procedurën se si do të veprohet në këtë vit të jashtëzakonshëm, për të mbajtur tekste e përzgjedhura një vit më parë, pasi ky proces duhej bërë në kohën kur u volitej të gjithëve, sidomos botuesve për të kryer procedurat e shtypjes, paketimit, pra të gjitha procedurat teknike që ata kanë për prodhimet e teksteve, që këto tekste t'i kenë fëmijët në duar në shtator, nëse do të jenë në bankat e shkollës.

Lidhur me maturën shtetërore, sikurse e dimë të gjithë matura shtetërore është një proces shumë i rëndësishëm për nxënësit që mbarojnë klasën e 12-të, pasi është një moment kur atyre u duhet të kalojnë nga arsimi i mesëm në universitete apo në tregun e punës.

Se si do të vepronim me provimet kombëtare dhe më shumë me provimet e maturës shtetërore, për këtë ne kemi bërë disa skenarë në funksion të ndryshimit të situatës në vendin tonë, për shkak të COVID-19-s. Pra, nga muaji mars deri tani ne kemi bërë disa skenarë lidhur me këtë situatë dhe kemi marrë këtë vendim, që provimet e maturës do të zhvillohen në datat e përcaktuara, me udhëzimin e ministrit që në vitin 2019, pra nga 8 qershor deri më 18 qershor.

Nxënësit maturantë, që të merrnin pjesë në provimet e maturës dhe të ishin edhe më të përgatitur, duhej të ktheheshin edhe një herë në bankat e shkollës, që të konsultoheshin edhe një herë me mësuesit e tyre vetëm për lëndët që do të japin në provimet shtetërore dhe më pas, deri më 8 qershor, ata do të përgatiten për provimet e maturës shtetërore.

Për këtë ne kemi hartuar një rregullore të posaçme, bazuar në rregulloren e maturës shtetërore. Pra, i gjithë procesi i maturës shtetërore do të kryhet në zbatim të kësaj rregulloreje, por me disa shtesa, që vijnë për shkak të kësaj situatë të jashtëzakonshme. Numri i maturantëve nuk do të jetë 15 apo 20 veta në klasë, por do të jetë 10 deri në 12 nxënës dhe vetëm në raste të rralla mund të ketë klasa me 15 nxënës. Pra, kjo situatë na ka bërë që të krijojmë një skemë të re të administrimit, që nuk është shumë e ndryshme nga ajo e një viti më parë, vetëm se kërkon pak më shumë njerëz të përfshirë në administrim.

Ajo që ndryshon këtë vit është se testet e maturës shtetërore nuk do të korrigjohen nga mësues vlerësues në mënyrë fizike, por do të vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në mënyrë dixhitale. Ndaj, këtë vit nuk ka sekretues në qendrat e provimit, pasi nxënësit do ta kenë testin me emrin e vet dhe provimin do ta zhvillojnë në shkollën e tyre, sigurisht, sipas rendit të përcaktuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, që harton testet e maturës shtetërore. Ky proces nuk ndryshon në formën madhore të administrimit, pra në administrim do të ketë mësues të të gjitha qyteteve dhe shkollave të Shqipërisë, do të ketë përfaqësues nga ministria që do ta monitorojnë dhe, sigurisht...

**Fatjona Dhimitri** – Sa efektiv është vlerësimi që do t’u bëhet provimeve? Sepse ju thatë që provimet nuk do të jenë të sekretuara, nuk do të jenë me kod, do të vendoset emri i studentit dhe do të monitorohen nga mësuesit e shkollave.

**Zamira Gjini** – Procesi do të jetë në kushte të larta të administrimit dhe testi është planifikuar...

**Fatjona Dhimitri** – Kush e garanton që do të jetë në kushte të larta sigurie?

**Zamira Gjini** – Ne për këtë jemi këtu, që të organizojmë procesin dhe të garantojmë maturantët, në radhë të parë, dhe të gjithë të tjerët, që procesi të jetë në kushte të larta dhe në zbatim të rregullores së maturës. Për të gjithë ata që do të shkelin këtë rregullore, do të ketë masa administrative, si për nxënësin, ashtu edhe për administratorët që janë mësues.

Unë dua të shtoj që teksti i maturës shtetërore këtë vit ka një ndryshim nga ai i vitit të mëparshëm, sepse pyetjet janë të gjitha me alternativa dhe nuk ka pyetje me zhvillim. Pra, meqenëse testi do të jetë me alternativa dhe nxënësit do të mbushin rrathët në fletën e përgjigjeve të tyre, mënyra e korrigjimit nga QSHA-ja do të jetë dixhitale. Kjo është një mënyrë e re, që garanton transparencë dhe një siguri të lartë në korrigjimin e testeve të provimit të maturës për maturantët. Këto teste, edhe pse janë me alternativa, janë bërë sipas niveleve, me nivelin e parë, të dytë dhe të tretë, njësoj sikurse edhe vite më parë, pra 40% të pyetjeve kanë dy nivelet e para dhe 20% për nivelin e tretë, që është edhe niveli më i vështirë.

Këtë vit i gjithë procesi i maturës shtetërore do të zhvillohet në shkollat e maturantëve dhe do të kemi më shumë qendra, pra do të jenë rreth 500 qendra, dhe numri i njerëzve që do t’i administrojnë do të jetë më i madh. Ne kemi marrë masat dhe kemi hartuar një plan veprimi për të gjithë procesin e maturës shtetërore, për të siguruar një proces me standarde të larta në administrim dhe në korrigjimin.

Dua të theksoj edhe diçka tjetër, kur kemi marrë këtë vendimmarrje na është dashur të konsultohemi edhe me përvojat e vendeve të tjera. Ne jemi në kontakt me të gjitha vendet e tjera të Europës, por edhe më larg, duke parë të gjitha raportet e OECD-së, Bankës Botërore, UNESCO-s dhe Bashkimit Europian se çfarë ndodh me vendet e tjera, pra çfarë bëjnë ato me mësimin *online* dhe me provimet kombëtare. Po të shikojmë, pak a shumë, është e njëjta situatë, pasi të gjithë jemi në pandemi. Mësimi *online* është zhvilluar në të gjitha vendet dhe me të njëjtat mënyra, sikurse edhe në Shqipëri. Edhe për provimet kombëtare ka pasur vendimmarrje sipas vendeve të ndryshme. Prandaj edhe ne morëm këtë vendim vetëm për provimet e maturës shtetërore.

Unë ju siguroj që do të ketë një proces në interes të maturantëve, duke bërë kujdes që diplomat të dalin më 1 korrik, për ata maturantë që duan të studiojnë jashtë shtetit, dhe që të



mos pengohen për aplikimet e tyre në universitetet jashtë, e njëjta gjë është edhe për maturantët e tjerë, pra diplomat do t'i kenë brenda muajit korrik.

**Besa Shahini** – Para se të bëni pyetje të tjera, sekretaria e komisionit na ka thënë se mbledhja do të zgjasë rreth 1 orë e gjysmë, pra kemi parashikuar që...

**Fatjona Dhimitri** – Është parashikuar 2 orë e gjysmë, pra nga ora 9:00 deri në orën 12:30.

**Besa Shahini** – Unë kam një mbledhje tjetër në orën 11:00. Prandaj, kam qëndruar 10 minuta më shumë sesa na keni kërkuar. Unë ju falënderoj për të gjitha pyetjet...!

**Fatjona Dhimitri** – Zonja Ministre, ne kemi nevojë të njihemi me përgjigjet e pyetjeve dhe jo me pjesën tjetër të stafit tuaj. Kjo është një praktikë që ndiqet gjithmonë në komisionin tonë, pra praktika e largimit tuaj. Të paktën të na e kishit bërë me dije, në mënyrë që ta zhvendosim mbledhjen në një ditë tjetër.

*(Flet zonja Shahini, por nuk dëgjohet.)*

Zonja Ministre, kjo seancë dëgjimore duhej të ishte bërë me kohë. Unë nuk mund të ndalem sot të zgjedhjet në universitete ose më mirë në kontrollin absolut që ju doni të vini mbi universitetet përmes këtyre zgjedhjeve. Nëse do të kem edhe mirëkuptimin e kolegëve të tjerë deputetë, dëshiroj të caktojme një seancë tjetër dëgjimore.

*(Flet zonja Shahini, por nuk dëgjohet.)*

Ju bëj me dije se nga këshillat studentorë, nga OJF-të e ndryshme dhe nga shoqëria civile ne kemi marrë kërkesa për një seancë dëgjimore me ju, lidhur me zgjedhjet në universitete. Pra, për këtë pjesë do të ishte mirë të caktohej një seancë dëgjimore më vete. Kjo është shumë e nevojshme, sepse nxjerr në pah edhe të vërtetat e shkarkimit të atyre pedagogëve që nuk i janë bindur urdhrat tuaj për zgjedhje në universitet.

*(Flet zonja Shahini, por nuk dëgjohet.)*

Zonja Ministre, pjesa e dytë e këtij komisioni kishte të bënte me pyetjet për universitetet dhe ju nuk u jeni përgjigjur këtyre pyetjeve, sepse po zgjidhni rrugën e largimit nga mbledhja, me justifikimin e ngarkesës së agjendës tuaj.

Zonja Ministre, për universitetet, në fakt, keni marrë një vendim, i cili e rrezikon rininë shqiptare. Ky është një vendim i papërgjegjshëm dhe jam shumë e bindur që nuk e keni konsultuar me stafin akademik, me pedagogë dhe rektorë.

Zonja ministre është larguar. Ajo e ka si procedurë largimin, kur nuk u përgjigjet dot pyetjeve dhe, kur e ka të pamundur vazhdimin e mbledhjes, ia mbulojnë kohën anëtarët e tjerë të maxhorancës, deputetë të këtij komisioni dhe ndonjë ekspert që sjell këtu, që nuk na tha asgjë.

Pra, zonja ministre u largua dhe përgjigjet për universitetet nuk i morëm. Këto përgjigje u interesojnë atyre studentëve që më kanë dërguar *e-mail* dhe më pyesin se çfarë do të bëhet me rimbursimin e qirave të konvikteve.

A i rimbursuat qiratë e banimit që u detyroheni këtyre studentëve?

A i keni rimbursuar pedagogët dhe studentët për shpenzimet e internetit, për kartat telefonike e të tjera?

Zonja Ministre, meqenëse nuk iu përgjigjet këtyre pyetjeve, si do të dezinfektohen fletët e provimit, që do të kalojnë dorë më dorë në universitet, pra nga pedagogët te studentët, të cilat do të korrigjohen, dhe pedagogët, nëse do ta marrin virusin, do t'ua çojnë familjarëve të tyre dhe do të rrezikohen të moshuarit e të tjerë? Po distancimi social si do të realizohet në auditoret e tejmbushura, zonja Ministre, që nuk na u përgjigje fare...?!

Pra, si do të realizohen rregullat e distancimit social në auditoret e tejmbushura dhe të mbipopulluara, aty ku studentët kryqëzohen jo vetëm në auditore, por edhe në tualetet dhe korridoret e shkollës?

Cilat janë masat që do të merren për të shmangur rrezikshmërinë që i kanoset jetës së këtyre studentëve?

Po provimet si do të bëhen, zonja Ministre? A do të zhvillohen *online* apo jo?

Çfarë më kanë kërkuar studentët? Më kanë kërkuar anulimin e pagesave të tarifave për këtë vit akademik, anulimin e pagesave të qirave të konvikteve, si masë e domosdoshme për të lehtësuar vështirësitë ekonomike me të cilat do të përballen. Më kanë kërkuar anulimin e mungesave të marra gjatë mësimin *online* të platformës së çorganizuar të mësimdhënies dhe krijimin e një arkivi leksionesh të çdo lënde, me qëllim rikuperimin e leksioneve të humbura nga vetë studentët.

Pra, zonja ministre duhej t'u përgjigjej këtyre pyetjeve dhe shumë e shumë pyetjeve të tjera. Ajo merr një vendim dhe i çon studentët drejt zonave bakterologjike, një vendim të papërgjegjshëm, në kundërshtim me atë që na dikton gjendja e jashtëzakonshme, eksperimenton me rininë shqiptare, kërkon ta zhdukë inteligjencën shqiptare dhe nuk i përgjigjet asnjë pyetjeje për universitetin dhe si përfundim zgjedh rrugën e largimit, siç e ka zgjedhur gjithmonë.

Kolegë deputetë, për mua sot kjo mbledhje është e mbyllur, sepse ministrja, normalisht, i dha përgjigjet!

Faleminderit!

Kalofshi një ditë të mbarë!

Mbledhja për sot është e mbyllur.

## **MBYLLET MBLEDHJA**